



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

**V E N D I M**

**Nr. 82, datë 26.04.2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 194, datë 29.10.2021, e z. M.S., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjinisë”<sup>2</sup>, nga ana e Fakultetit të Drejtësisë (UT) dhe z. E.M., lektor i lëndës “E drejtë Ndërkombëtare Publike” pranë këtij fakulteti.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, z. M.S. është student ekselence që vazhdon studimet pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Z. M.S. pretendon se në datën 08.09.2021 është përjashtuar padrejtësisht nga provimi i lëndës “E drejtë Ndërkombëtare Publike”, e cila është lëndë që jepet mësim nga ana e lektorit E.M.. Ankuesi sqaron se ka dashur ta përsërisë këtë provim në muajin shtator 2021, me qëllim përmirësimin e notës 8 (tetë), me të cilën ishte vlerësuar më parë në këtë lëndë.

Z. M.S. pretendon se në respektim të së drejtës për arsim, në momentin e identifikimit të studentëve pjesëmarrës në provim, ai ka kërkuar shpjegime nga lektorja F.Sh., titullare e lëndës, lidhur me metodikën e zhvillimit të provimit. Sipas ankuesit, lektorja i është drejtuar në vijim, duke përdorur një gjuhë të papërshtatshme ndaj tij, në sy të të gjithë studentëve të

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

<sup>2</sup> Në ankesën e depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, pretendimi i tij fillimisht ka qenë diskriminim për shkak të gjendjes arsimore. Në vijim, ankuesi e tërhoqi shkakun e diskriminimit “gjendja arsimore” dhe pretendoi për shkak latent, e në vijim pretendoi diskriminim për shkak të “gjinisë”.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

tjerë, pjesëmarrës në provim. Këtë veprim të znj. F.Sh., ankuesi e konsideron si cënim të lirisë së shprehjes.

Në vijim, ai është përjashtuar nga provimi, me motivacionin se kamera e tij ka qenë e mbyllur gjatë kohës së zhvillimit të provimit. Ankuesi sqaron se edhe studentë të tjerë gjatë këtij provimi i kanë patur kamerat të mbyllura, por në asnjë rast nuk janë përjashtuar, sikurse ka ndodhur me të. Përveç sa më sipër, ankuesi sqaron se sipas Rregullores së Posaçme të Universitetit të Tiranës “*Mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online të sezonit të dimrit të vitit akademik 2021-2022*” parashikohet se si rregull kamera duhet të mbahet hapur gjatë provimit, por një gjë e tillë nuk është e detyrueshme. Z. M.S. pretendon se në procesverbalin e provimit të kësaj lënde, për të, është vënë shënimi “*Nuk u paraqit*”, por pavarësisht kësaj, nuk u la në fuqi nota e parë e marrë nga ankuesi, por ai është vlerësuar me notë pakaluese.

Ankuesi pretendon se në Fakultetin e Drejtësisë nuk janë zbatuar standardet e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, lidhur me zhvillimin e provimeve. Ai thekson faktin se në fakultetet e tjera, i njëjti fakt për të cilin ai ka pretendime, është zbatuar në mënyrë të ndryshme nga rasti konkret, pranë Fakultetit të Drejtësisë. Njëkohësisht, ai vë në dukje faktin se është ankimuar pranë Rektoratit të Universitetit të Tiranës, por megjithëse ka kaluar afati 30 ditor, nuk i është dërguar asnjë përgjigje mbi ankesën e tij. Ankuesi thekson faktin se veprimi i lektorit E.M. ka sjellë si pasojë humbjen e bursës që z. M.S. merrte, në cilësinë e studentit të ekselencës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 194, datë 29.10.2021, e z. M.S., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Fakultetit të Drejtësisë dhe z. E.M., si dhe për dijeni MAS, Rektoratit të Universitetit të Tiranës dhe ankuesit, me shkresën nr. 1506/1, datë 03.11.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

---

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
  2. Informacion mbi rregullat e përcaktuara, lidhur me standardet e zhvillimit të provimeve në Universitetin e Tiranës për vitin 2021-2022;
  3. Informacion mbi faktin nëse mbajtja e kamerave të hapura është rregull i detyrueshëm gjatë zhvillimit të provimeve;
  4. Kopje e procesverbalit të provimit të datës 08.09.2021, për lëndën “E drejta ndërkombëtare publike”;
  5. Kopje e procesverbalit të provimit paraardhës, në të njëjtën lëndë, ku ankuesi është vlerësuar me notën 8 (tetë).
  6. Kopje të listave të notave për ankuesin M.S.;
  7. Informacion nëse ankuesi është student i ekselencës dhe nëse ka qenë përfitues i bursës përkatëse;
  8. Informacion nëse z. M.S. aktualisht është përfitues i bursës së sipërcituar;
  9. Çdo informacion tjetër që e konsideroni të nevojshëm për çështjen objekt shqyrtimi;
- Në përgjigje të shkresës nr. 1506/1, datë 03.11.2021, së KMD-së, Rektorati i Universitetit të Tiranës dërgoi shkresën nr. 2363/6 prot., datë 22.11.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se me shkresën nr. 905/7 prot., datë 16.11.2021, Fakulteti i Drejtësisë ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për trajtimin e ankesës së z. M.S., të cilin Rektorati i UT-së, po e përcjell pranë KMD-së. Njëkohësisht në shkresën e sipërcituar, ky institucion vë në dukje faktin se ankuesi është sqaruar në mënyrë të përsëritur mbi fazat e trajtimit të ankesës së tij, si dhe i janë vënë në dispozicion dokumentet përkatëse.

Bashkëlidhur shkresës së Rektoratit të UT është dërguar dokumentacioni i plotë, i përcjellë nga Fakulteti i Drejtësisë, lidhur me kryerjen e verifikimeve mbi ankesën e z. M.S..

- Zarfi me shkresën e KMD-së drejtuar z. E.M. u kthye mbrapsht nga shërbimi postar, me shënimin “objekt i pakërkuar” (lektor i jashtëm).
- Në vijim, me e-mailin e datës 18.11.2021, ankuesi M.S. tërhoqi shkakun e diskriminimit për shkak të “gjendjes arsimore” dhe kërkoi që pretendimi i tij të mbështetet në opsionin “për çdo shkak tjetër”. Në e-mailin e tij citohet: “Në ankesë - kërkesën time kam përzgjedhur diskriminim për shkaqe të gjendjes arsimore. Nisur nga saktësimi që dua t’i bëj objektit të kërkesës, ju shpreh se objekti im duhet të ndryshohet për shkaqe se nuk hyn në sferën që kam përzgjedhur në formularin e ankesës. Gjykoj se kërkesa ime duhet të ketë në objekt shkakun e diskriminimit “për çdo arsye tjetër”, pasi nuk mund të kategorizohet si diskriminim për shkak të gjendjes arsimore....”
- Në të njëjtën datë, inspektorja e çështjes i është drejtuar ankuesit me e-mail duke i kërkuar që të saktësonte shkakun e diskriminimit të pretenduar, si dhe të jepte shpjegime mbi

lidhjen shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar dhe trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit z. M.S. pretendonte se ishte ekspozuar.

- Me e-mailin e datës 19.11.2021, ankuesi sqaron se: *“Nisur nga sa më lart kërkoj, në datën 08.09.2021 kam patur një konflikt me pedagogen Znj. F.Sh. gjatë apelit para zhvillimit të provimit. Pedagogia, duke m'u drejtuar me një gjuhë të papërshtatshme më çënoi të drejtën për t'u shprehur dhe më paragjykoi mendimin e lirë duke më vendosur në kushte veçanërisht të rënduara në raport me studentët e tjerë, në platformë. Nisur nga kjo unë reagova duke e etiketuar si të paedukatë për shkak të demoralizimit të thellë moral e shpirtëror në ato çaste. Në momentin që jam futur në provim, pedagogu Z. E.M. më përjashtoi në një kohë prej 1 minuti për shkak se kamera ime ishte e mbyllur (pas dy paralajmërimeve të orkestruara me shpejtësi) duke mos më dhënë mundësinë për të rihyrë në provim edhe pse sipas rregullores unë i shpjegoja që kamera ka probleme teknike dhe, pavarësisht se e rregullova, nuk denjoi t'a marrë për bazë. Ekziston dyshimi i arsyeshëm bazuar në prova se Z. E.M. ka reaguar për motive personale pasi në platformë evidentohet se dhe studentë të tjerë e kanë patur kamerën e mbyllur dhe nuk janë përjashtuar.”*
- Në datën 24.11.2021, mbështetur në kërkesën e z. M.S., iu dërgua me e-mail shkresa e dërguar nga ana e Rektoratit të UT-së, në adresë të KMD-së.
- Në të njëjtën datë, pas analizimit të shkresës së Rektoratit, ankuesi iu drejtua me e-mail KMD-së duke sqaruar si vijon:

*“Në lidhje me respektimin e parimit të sigurisë juridike: “Nga ana e Z. E.M. nuk rezulton se ka ndjekur një praktikë uniforme me pedagogët e tjerë, pasi provimet e vjeshtës bëhen kryesisht me shtjellim. Në lidhje me shpjegimin: “Nga ana e Znj. F.Sh. më janë drejtuar fjalë fyese dhe jo ato që përcillen në shkresë. Fjalori i pedagoges ka qenë informal dhe për këtë do t'ju sjell edhe dëshmitë e disa studentëve që e provojnë këtë gjë.*

*Në lidhje me përjashtimin është tërësisht e pavërtetë që lektori më ka tërhequr vëmendjen disa herë së bashku me kolegen e tij, Znj. Sh. Pedagogu është mjaftuar vetëm 2 herë në mënyrë të shpejtë, pa hezituuar aspak të lejojë kohë që unë të rikuperoj kamerën. Pas 2 minutash provat vërtetojnë se kamera ime ka qenë e hapur dhe tregon se shkëputja teknike nuk është bërë me vullnetin tim ndryshe nga sa pretendojnë pedagogët.*

*Shefja e departamentit publik nuk ka kryer asnjë hetim në lidhje me procesin e zhvilluar online, por është konstatuar vetëm nga sa i është thënë nga ekipi i lëndës që më ka përjashtuar nga provimi. Gjithashtu, në formë verbale shefja e departamentit është shprehur se nuk është organ që heton/kontrollon pedagogët, por vetëm verifikon. Nisur nga kjo, unë kam këmbëngulur në ngritjen e komisionit ad hoc, siç dhe vërtetohet nga materialet që janë*

*përcjellë, por nga ana e dekanit të fakultetit të Drejtësisë nuk është pranuar ngritja e një komisioni të tillë duke më mohuar të drejtën për arsim pasi në bazë të rregullores, dekani e ka detyrim automatikisht të ngrejë komisionin ad hoc që shqyrton pretendimet e studentit në lidhje me vlerësimin. Kjo del edhe nga interpretimi literal ku thotë: “ngre komisionin dhe shqyrton pretendimet e studentit”. Në këtë kuadër, mosngritja e një komisioni të tillë paragjykon të drejtën për arsim dhe i jep mundësi pedagogëve që të mos japin llogari për veprimet/mosveprimet e tyre në ushtrimin e funksioneve publike. Dekani është mjaftuar me konstatimin e asaj çfarë konstaton shefja e departamentit publik, Znj. Jançe, duke mos zbatuar rregulloren.*

*Në përputhje me këtë akt kam paraqitur ankim në rektorat, ku pavarësisht se jam shpjeguar disa herë verbalisht si nga sektori i shërbimeve juridike ashtu edhe në një takim me rektorin, nuk kam marrë një përgjigje zyrtare konform ligjit. Në asnjë prej e-mail-eve që kam dërguar nuk kam legjitimuar veprimet e Znj. F.Sh., por kam kërkuar ndjesë për shkak të pozicionit të tyre si pedagog dhe për të treguar shprehjen e përuljes sime si student dhe solidaritetit për të zgjidhur çështjen me mirëkuptim.*

*Në lidhje me problemin teknik të kamerës është totalisht e pavertetë se më është dhënë mundësia për të shprehur se kamera është shkëputur për shkak të problemeve teknike për arsye se lektori më ka përjashtuar në një kohë relativisht të shpejtë duke mos më mundësuar kontaktin me të. Kjo del edhe nga pamjet e dërguara si provë, ku vërtetohet se jam përjashtuar nga provimi aq shpejtë sa nuk mund të mundësohet kontakti me pedagogët në kushtet kur unë automatikisht jam përjashtuar nga provimi. Megjithatë, e kam vënë në dijeni edhe pas kryerjes së provimit se kam patur probleme teknike duke e përforcuar edhe me mesazhin e dërguar nga ana e ekspertit të IT së Fakultetit, i cili shprehet që zhvillimi i provimit me telefon jep probleme. Edhe pse pedagogu është njoftuar për këtë nuk ka marrë asnjë veprim për të më rikthyer në gjendjen e mëparshme.....”.*

- Në datën 25.11.2021, ankuesi dërgoi sërish e-mail në adresë të KMD-së duke sqaruar se “Diskriminimi i Z. E.M. është një diskriminim me shkak latent (të fshehur) pasi nuk mund të kuptohet për çfarë arsyeje më ka përjashtuar nga provimi i datës 08.09.2021, në shkelje të së drejtës për arsim. Z. E.M. i shpjegon Komisionerit në pjesën IV) të raportit se dhe studentja H. K. është përjashtuar për shkak të kamerës. Ky është qëllimi i pedagogut për të treguar se unë nuk jam i vetmi që jam përjashtuar për këtë shkak, në mënyrë që të mbulojë diskriminimin latent. Por është vërtetuar nga thëniet e Znj. H.K. se përjashtimi i saj nuk ka ardhur për këtë gjë, madje ajo nuk është përjashtuar por pretendon se pedagogët i kanë shkelur vlerësimin vetëm për të legjitimuar veprimet që kanë kryer ndaj meje. Ata nuk i kanë dërguar asnjë provë studentes se kamera e saj ka qenë e mbyllur duke keqinformuar komisionerin.”

- Në datën 26.11.2021, ankuesi i drejtohet sërish KMD-së me e-mail, duke përcaktuar se shkak i diskriminimit të tij është “gjinia”. Sipas tij, ka patur studente femra, të cilat nuk janë penalizuar si pasojë e mbajtjes së kamerës mbyllur, ndërkohë që ai është përjashtuar nga provimi për të njëjtën arsye. Njëkohësisht, ai mohon faktin se znj. H. K. është përjashtuar nga provimi për shkak të mbylljes së kamerës, duke theksuar faktin se një gjë të tillë e ka pohuar ajo vetë.
- Në vijim të e-mailit të sipërcituar, ankuesi M.S. ka dërguar pranë KMD-së, e-maile të tjera, nëpërmjet së cilave sqaron diskriminimin e kryer ndaj tij.
- Pas informacionit të marrë nga ankuesi, KMD procedoi duke iu drejtuar sërish subjekteve kundër së cilëve drejtohej ankesa, nëpërmjet shkresës nr. 1506/3, datë 17.12.2021, të cilët fillimisht u njoftuan mbi ndryshimin e shkakut të diskriminimit nga ana e ankuesit, e në vijim iu kërkua informacioni vijues:
  1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet aktuale të ankuesit;
  2. Të dërgohet lista emërore e studentëve të përjashtuar nga provimi i lëndës “E drejtë Ndërkombëtare Publike”, të zhvilluar në datën 08.09.2021, pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, ku të evidentohet edhe motivacioni i përjashtimit. Bashkëlidhur të dërgohen procesverbalet përkatëse;
  3. Çdo informacion tjetër që e konsideroni të nevojshëm për çështjen objekt shqyrtimi;
- Fakulteti i Drejtësisë nuk dërgoi përgjigje në adresë të KMD-së;
- Me e-mailin e datës 12.01.2022, z. E.M. dërgoi në adresë të KMD-së, shkresën nr. 10/1 prot., datë 12.01.2022, nëpërmjet së cilës e bën me dije KMD-në se nuk është njohur me provat e depozituara nga ankuesi, por nëse këto prova konsistojnë në të njëjtat foto që z. M.S. ka dërguar me e-mailin e datës 10.01.2022, ora 11:45 (e darkës), ai vë në dukje faktin, që ndërkohë që studenti do të duhej të ishte duke iu përgjigjur pyetjeve të provimit, ka patur kohë që t’i bëjë edhe fotografi vetes (screenshot), që tregon se kjo foto i është bërë pasi i është komunikuar vendimi për skualifikimin e tij, si rrjedhojë e mosndezjes së kamerës për disa minuta rresht, kohë e mjaftueshme për të kryer veprime në kundërshtim të Rregullores së Posaçme mbi zhvillimin e veprimeve *on line*, thënë ndryshe, për të mundësuar konsultimin me materiale që ndalohen të përdoren gjatë provimit, gjë që barazohet me kopjimin në provimin që zhvillohet në auditor, parashikuar në nenin 89 të Rregullores së UT-së, miratuar me Vendimin nr. 5, datë 12.04.2010, të Senatit Akademik të UT, si shkelje disiplinore. Ankuesi e ka pranuar që e ka dëgjuar thirrjen për të ndezur kamerën, gjë që provon se ka patur lidhje me internetin. Fakti që ankuesi, pasi i është komunikuar vendimi i skualifikimit nga provimi, ka ndezur kamerën dhe ka bërë fotografinë që ju ka paraqitur në cilësinë e provës, tregon qartë që z M.S. nuk ka patur

probleme me internetin, por në mënyrë të vullnetshme nuk ka ndezur kamerën deri në momentin që iu komunikua vendimi i skualifikimit.

Z. E.M. thekson faktin se pavarësisht këtij konstatimi, siç i është bërë e ditur ankuesit dhe autoriteteve të Universitetit të Tiranës, që janë vënë në lëvizje abuzivisht nga ankuesi prej mëse 4 muajsh, duke shpenzuar kohë dhe energji që do të duhej të ishin vënë në dobi të mbarëvajtjes së këtij institucioni të arsimit të lartë, ai nuk ka qenë e vetmi student me kamerën mbyllur, pasi ka patur edhe student të tjerë që kanë kryer të njëjtin veprim, duke shpresuar që pedagogët nuk do të ishin të vëmendshëm, meqë provimi do të zhvillohej *on line* dhe mbikqyrja nuk do të ishte e lehtë. Por, në dallim nga ankuesi, kur u bë paralajmërimi nga pedagogët e lëndës, që nëse nuk ndiznin kamerat, do të skualifikoheshin, studentët e tjerë reagues menjëherë, brenda disa sekondave, duke ndezur kamerat, ndërkohë që ankuesi, pavarësisht thirrjeve të përsëritura, refuzonte të ndizte kamerën, e për këtë arsye u skualifikua. Pra, çdo student që u konstatua me kamerën e fikur, u thirr individualisht për të reaguar, e në dy raste, kur nuk pati reagim, masat disiplinore ndaj shkelësve të pikës 5.3, të nenit 4, të Rregullores së Posaçme të UT “*Mbi zhvillimin e provimeve online për sezonin e dimrit 2020-2021*”, u morën individualisht siç u veprua me dy shkelësit që nuk reagues pas thirrjeve të përsëritura, z. M.S. dhe znj. H. K.

Së dyti, në shkresën e z. E.M. sqarohet se pretendimi se asnjë prej studentëve të gjinisë femërore nuk është përjashtuar, është haptazi abuziv dhe i pavërtetë, sepse krahas z. M.S., studentja tjetër e skualifikuar për shkak të mbylljes së kamerës gjatë provimit është znj. H.K., e gjinisë femërore. Po aq abuziv dhe i pavërtetë është edhe pretendimi se arsyeja e përjashtimit të saj nga provimi lidhet me motivacion tjetër, ndërkohë që nuk shprehet për këtë “motivacion tjetër”, i cili nuk ekziston, por është një trillim i qëllimshëm, abuziv i ankuesit. Një pretendim i tillë që lidhet me një studente tjetër, e cila ka pranuar vendimin e skualifikimit dhe nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi, tregon për natyrën abuzive, problematike dhe të paqëndrueshme të z. M.S., paqëndrueshmëri që reflektohet si në pretendimet e tij të ndryshuara vazhdimisht për diskriminim, ashtu edhe në vlerësimin e tij për pedagogët e lëndës, përgjatë vitit akademik.

Në lidhje me këto të fundit, z. E.M. kërkon nga KMD që të vihet re qendrimi i ankuesit në statuset e hedhura prej tij në Platformën Microsoft Teams, bashkëlidhur kësaj shkrese, ku shprehet ndër të tjera, në datat 01.02.2021, 04.03.2021 dhe 08.09.2021, para zhvillimit të provimit:

[2/2 7:44 PM] M.S.

*Nderim për pedagogët e së drejtës ndërkombëtare. Me kapacitet perfekt në fushën e tyre dhe ezaurues. Në veçanti ju, Z. Erion ju shpreh mirënjohjen dhe falenderimin që kam qenë student juaj.*

[3/4 10:24 PM] M.S.

*I nderuar prof. E.M.. Një preokupim i madh i juaji, i ka dhënë vlerë dijës time në këtë lëndë. Ky mesazh vjen në shenjë falenderimi për ju, stilin dhe mënyrën se si e zhvilloni lëndën. Kjo gjë ju bën unik, përtej seriozitetit tuaj, të theksuar. Merrni falenderimet e mi më të sinqerta!*

Z. E.M. vë në dukje faktin se para fillimit të provimit, në orën 11:00, të datës 08.09.2021, z. M.S. i është drejtuar me fjalët: “...mesa shoh jeni i vetmi nga pedagogët që respektoni parimet”, siç provohet në dokumentacionin provues që është depozituar pranë KMD-së.

Për sa më sipër, z. E.M. pasi bën citimin e nenit 3, të LMD, të ndryshuar, nenit 14 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit 12 të saj, thekson faktin se në jurisprudencën e saj të konsoliduar, GJEDNJ është shprehur se: “*diskriminimi është trajtimi i ndryshëm, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relevante të ngjashme; me fjalë të tjera, ka diskriminim, nëse dallimi nuk ndjek një qëllim legjitim, apo masat e marra për ta arritur atë nuk kanë një lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit me të*” (Vendimi nr. 5335/05, datë 21.06.2011, *Ponomaryovi kundër Bullgarisë*, paragrafi 51).

Z. E.M. thekson faktin se në rastin konkret, ndaj ankuesit nuk është bërë asnjë dallim, përjashtim, kufizim si dhe nuk është treguar asnjë preferencë bazuar në gjininë, pasi Rregullorja e UT është zbatuar me korrektësi dhe në mënyrë proporcionale me shkeljen, ndaj çdo shkelësi të saj, si ndaj z. M.S. që është mashkull, ashtu edhe ndaj znj. H.K. që është femër. Përveçse nuk është bërë asnjë dallim, përjashtim, kufizim, si dhe nuk është treguar asnjë preferencë bazuar në gjininë, masa e marrë ndaj shkelësve të Rregullores së UT është proporcionale me shkeljen, në kushtet kur veprimi i kryer prej tyre konsiderohet si një shkelje disiplinore nga neni 89 i Rregullores së UT, krahas veprimeve që çenojnë personalitetin e të tjerëve, rregullat dhe normat etiko-morale të shoqërisë, aktet e rrugaçërisë etj. Gjithashtu, kjo masë vendos balancën e duhur midis interesit individual dhe interesit publik, që konsiston në mbrojtjen e marrëdhënieve shoqërore në një mjedis akademik. Krejt e kundërta do të ndodhte sikur ndaj shkelësve të Rregullores së UT të mos merrej asnjë masë, pasi do të diskriminoheshin studentët e tjerë që respektojnë rregullat dhe sillen në përputhje me parimin e ndershmërisë akademike. Të njëjtin qendrim ka mbajtur edhe Avokati i Popullit, që nëpërmjet shkresës nr.K1/M14-6, datë 17.12.2021 ka informuar ankuesin se “...veprimet e ndërmarra nga stafi akademik i Fakultetit të Drejtësisë janë të bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”.

Z. E.M. shprehet se sikurse janë shprehur të dy gjykatat, GJEDNJ dhe GJED “*qeverisja më e mirë në një sistem demokratik kërkon balancimin e interesave të palëve, bazuar në ligj*”. Në rastin konkret, qeverisja e mirë e procesit akademik, pjesë e së cilit janë edhe provimet, kërkon ndërshkimin e shkelësve të Rregullores së UT, për garatimin e procesit të rregullt akademik dhe mbrojtjen e interesave të shumicës mbizotëruese të studentëve, që respektojnë rregullat.

Lektori thekson faktin se përveç pretendimeve abuzive të sipërcituara, në vijim të ndryshimeve të pretendimeve për diskriminim, në e-mail-in e dërguar në datën 10.01.2022,



ora 11:38 (në darkë), bashkëlidhur kësaj shkrese, ankuesi shton edhe një motivacion tjetër “veprimet e lektorit janë bërë për të më përjashtuar nga bursa”. Z. E.M. sqaron se qartazi ndodhemi në kushtet e pretendimeve të vazhdueshme abuzive, të pavërteta dhe të paqëndrueshme, pasi çështjet që lidhen me bursat e studentëve janë kompetencë e autoriteteve të financave, ndërsa personeli akademik i FDUT nuk ka kompetencë, as informacion në lidhje me to.

Së treti, z. E.M. sqaron se lista emërore e studentëve të skualifikuar nga provimi i datës 08.09.2021, për shkak të shkeljes së pikës 5.3 të nenit 4 të Rregullores së Posaçme të UT “Mbi zhvillimin e provimeve on line për sezonin e dimrit 2020-2021” është: 1- z. M.S. dhe 2- Znj. H. K.

Së katërta, në lidhje me procesverbalin e kërkuar nga KMD në cilësi prove, z. E.M. sqaron se në Rregulloren e UT-së, të miratuar me Vendimin nr. 5, datë 12.04.2010, të Senatit Akademik të UT, nuk parashikohet mbajtja e një procesverbali të tillë, në rastet kur kryhen akte që sipas nenit 89 të saj konsiderohen shkelje disiplinore, ku përfshihen ndër të tjera edhe veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e të tjerëve, rregullat dhe normat etiko-morale të shoqërisë si: kopjimi në provime, aktet e rrugaçërisë etj., kur këto veprime nuk mbartin element të veprës penale. Por, për vendimin e skualifikimit është njoftuar Përgjegjësja e Departamentit të së Drejtës Publike, znj. Kristinka Jançe, siç provohet nga e-maili i datës 09.09.2021, bashkëlidhur kësaj shkrese.

Në përfundim, z. E.M. vë në dukje faktin se një student i Universitetit të Pizës nuk do të mund t’i drejtohej kurrë pedagogut të tij me shprehjet e përdorura nga ankuesi ndaj tij dhe kolegëve të tjerë lektorë, të tilla si: “...Gjithashtu ju keni ndikuar edhe tek ish-Dekani i Drejtësisë, për mosngritjen e komisionit ad hoc, në përputhje me statutin e UT, pasi nuk keni dashur që të hetoheshit për veprimet tuaja të kundraligjshme, që kanë sjellë mohim të së drejtës sime për arsim....Gjithashtu, ju ndërhytë në institucionin e Avokatit të Popullit. Ju ndërhytë në Rektorat, ku unë nuk mora përgjigje brenda afatit 30 ditor. “Ushtarë të një sistemi të paskrupullt”, “pedagogë që përdorin metoda grabitqare, të ndyrë, të poshtra, tinzare dhe brutale”, “jeni spiunë që plotësoni hakmarrjet e kolegëve”, “e paedukatë dhe arrogante”, “nuk jemi në auditor pa ja tregonim si bëhet detyra” etj. Shprehjet të tilla joetike, fyese, kërcënuese, për shkak të ushtrimit të detyrës së lektorit, nuk duhet të gjejnë vend në një mjedis të qytetëruar, aq më pak, në një mjedis akademik.

Z. E.M. shprehet se në funksion të ushtrimit të detyrës së KMD-së, është i gatshëm të vendosë në dispozicion çdo informacion që nevojitet në format shkresor ose elektronik, që do të vlerësohet i dobishëm nga Komisioneri.

- Në vijim, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 02.02.2022, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit ankuesi M.S., lektori E.M. dhe Zv/Dekani i Fakultetit të Drejtësisë, z. J. B.

Fillimisht, Komisioneri u parashtroi palëve në proces mundësinë e zgjidhjes së çështjes me anë të pajtimit. Z. E.M. u shpreh se kjo çështje nuk mund të zgjidhej me ndërmjetësimin e KMD, pasi në bazë të Rregullores së UT, studenti M.S. nuk ka marrë vlerësim kalues dhe për këtë arsye, ai duhet të ripërsërisë provimin.

Z. M.S. sqaron se në datën 08.09.2021, ora 14:00, është zhvilluar provimi i lëndës së të drejtës ndërkombëtare publike, për sezonin e vjeshtës, në të cilin ai ka marrë pjesë për të përmirësuar notën 8 (tetë) të marrë në këtë provim. Provimi është zhvilluar *on line*, nëpërmjet Platformës Teams. Ankuesi sqaron se fillimisht i është drejtuar z. E.M., për sa i përket mënyrës se si do të zhvillohej provimi, pra nëse provimi do të zhvillohej me alternativa apo me shtjellim. Z. E.M. i është përgjigjur se provimi do të zhvillohej me alternativa, sikurse ishte zhvilluar edhe më parë. Në vijim, ankuesi sqaron se i është drejtuar për sqarim lektores F.Sh., në cilësinë e titullares të kësaj lënde. Z. M.S. pretendon se lektorja e sipërcituar i është përgjigjur me shprehjen *“nuk ju jap llogari juve”*<sup>5</sup>. Ankuesi shpjegon se pas marrjes së një përgjigjeje të tillë në sy të të gjithë studentëve të tjerë, pjesëmarrës në provim, nuk është vetëpërmbytur, por i është drejtuar lektores me shprehjet *“jeni e paedukatë”, “keni shpërdoruar detyrën”, “nuk është kjo mënyra se si duhet t’i drejtoheni studentit”, “nuk është kjo etikë institucionale”*. Z. M.S. pretendon se në vijim të këtyre shprehjeve të përdorura nga ana e tij, lektorja nuk ka reaguar. Në vijim, ka filluar provimi dhe në minutën e 13-të, z. E.M. i është drejtuar z. M.S., me ton kërcënues që të mbante kamerën hapur. Ankuesi sqaron se në kushtet kur provimin po e zhvillonte me celular, ka patur probleme teknike. Si pasojë, ndërprerja e lidhjes me kamera me provimin që zhvillohej *on line* ka ndodhur për një periudhë kohore prej 2 minutash. Për këtë shkak, ai është përjashtuar nga provimi dhe është vlerësuar me notë jo kaluese, edhe pse kamera e tij ka qenë e hapur në vijim.

I pyetur nga Komisioneri, nëse përjashtimi i tij nga provimi ka ndodhur për shkak të konfliktit paraprak të ndodhur me lektorët apo për shkak të gjinisë, ankuesi është shprehur se konflikti i tij ka qenë me lektoren F.Sh., jo me lektorin E.M.. Njëkohësisht, ai u shpreh se duke mos patur mundësi të vërtetojë se pasojat i kanë ardhur nga konflikti me këtë lektore, si dhe në kushtet kur KMD është një institucion që shqyrton ankesat e mbështetura në prova dhe fakte që lidhen me shkaqe të tilla, ai mbështet pretendimin e diskriminimit për shkak të gjinisë.

Ndër të tjera, ankuesi u shpreh se është deklaruar se sikurse ai, është përjashtuar për të njëjtën arsye edhe studentja H.K. Z. M.S. pretendon se znj. H.K. e mohon se është përjashtuar për një fakt të tillë, pasi z. E.M. nuk e ka njoftuar për një gjë të tillë.

I pyetur sërish nga KMD, mbi mënyrën e vlerësimit nga lektorët, si pasojë e përjashtimit nga provimi, ankuesi u shpreh se ata kanë kryer një interpretim jo të saktë të saj. Ai sqaroi se përgjithësisht, studentët që marrin pjesë në provimet e sezonit të vjeshtës, nuk penalizohen me nota

---

<sup>5</sup> Shprehja e përdorur nga ankuesi në seancë dëgjimore.

më të ulëta se ajo që kanë marrë më parë. Si pasojë e notës së marrë në këtë lëndë, ai është përjashtuar nga lista e atyre studentëve, të cilët shteti i trajton me bursë. Kjo pasi në bazë të Vendimin nr. 40, datë 23.01.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave”, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, të cilat përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, që studenti të përfitojë bursë duhet që mesatarja e tij të jetë 9 deri në 10, si dhe të ketë shlyer të gjitha detyrimet. Në kushtet kur, si pasojë e përjashtimit nga provimi i së drejtës ndërkombëtare publike, ai rezulton jo kalues në këtë lëndë, kjo lëndë konsiderohet e pashlyer dhe si rrjedhim ai nuk përfiton bursë financiare.

Në vijim, KMD iu dha fjalën z. E.M., i cili pasi lexoi prapësimet e tij, të dërguara me e-mail në adresë të KMD-së, në datën 12.01.2022, kërkoi informacion mbi një raport të KMD-së, për të cilin ankuesi M.S. ishte shprehur në e-mailin e datës 15.01.2022, ora 13:00, pika 5, e pretendimeve të ankuesit, të dërguar në adresën e tij, ku citohet shprehimisht një Raport i KMD-së, nëpërmjet së cilit supozohet se ky institucion ka dalë në përfundimin se pasojat e ankuesit kanë ardhur si rrjedhim i konfliktit me lektorët e lëndës. Në kushtet kur, KMD nuk kishte dijeni mbi një raport të tillë, iu drejtua ankesit për të sqaruar situatën. Ankuesi sqaroi se ishte lapsus dhe kërkoi ndjesë lidhur me sa më sipër.

KMD e pyeti ankuesin nëse e ka ankimuar vlerësimin e bërë nga lektorët e lëndës dhe ai u përgjigj se e ka ankimuar në bazë të nenit 51, të Rregullores së UT, brenda 48 orëve nga vlerësimi i lektorit. Sipas këtij neni, kur përgjegjësja e Departamentit nuk e zgjidh dot çështjen në fjalë ia kalon për kompetencë dekanit të fakultetit. Është zhvilluar një takim mes tyre që është incizuar me pëlqimin e tij. Në këtë takim nuk është rënë dakord mes palëve. Ankuesi sqaron se ka kërkuar krijimin e një komisioni *ad hoc*, që bën vlerësimin përfundimtar të studentit. Departamenti i ka drejtuar shkresë Dekanantit, ku rezulton se nuk ka shkelje. Dekanati mjaftohet me këtë shkresë dhe nuk ka kryer hetime të tjera.

I pyetur nga KMD nëse ai i ka dëgjuar thirrjet e lektorit për hapjen e kamerës dhe ka reaguar duke i njoftuar për problemin teknik, ankuesi shprehet se i dëgjonte thirrjet e tij dhe i ka thënë “*ju lutem më lejoni të bëj provimin*” dhe “*ju po bëni atentat*”, pasi nuk ishte në dijeni të shkëputjes së lidhjes së kamerës. Ankuesi sqaron se vetëm pas thirrjes së dytë ka konstatuar se lidhja me kamera ishte shkëputur nga sistemi. I pyetur nga KMD nëse një gjë e tillë i kishte ndodhur edhe në provime të tjera, ankuesi sqaron se kjo situatë nuk i ka ndodhur ndonjëherë. I pyetur se me ç’mjete kishte kryer provimet e tjera *on line*, ai u përgjigj se nuk kishte përdorur celularin, por mjete të tjera alternative. KMD e pyet ankuesin nëse ishte në dijeni të parashikimit të Rregullores së UT-së se është detyrim i studentit që duhet të marrë masa teknike për zhvillimin e provimit, ankuesi u përgjigj se kishte dijeni për një parashikim të tillë, por vetëm në vijim ka marrë shpjegime nga specialistë të fushës, që situata të tilla mund të ndodhin kur provimi kryhet nga celulari.

Në vijim, KMD pyeti z. E.M. nëse ka patur raste të tjera analoge me atë të z. M.S., ai u përgjigj se nuk ka patur raste të tilla pasi studentët përgjithësisht janë të rregullt. Ai sqaroi se edhe znj. H.K. është përjashtuar për të njëjtën arsye dhe nuk ka kryer asnjë ankim ndaj këtij vendimi, pasi e ka pranuar gabimin e bërë.

KMD e pyeti gjithashtu z. E.M., nëse z. M.S. e ka njoftuar se ka probleme teknike me kamerën. Z. E.M. u përgjigj se në asnjë rast ankuesi nuk e ka njoftuar se ka patur probleme teknike. Ai citoi disa dispozita të Rregullores, ku ai pretendoi se ankuesi është në shkelje. Ankuesi ndërhyri duke u shprehur se rregullorja është diskriminuese. Z. E.M. u shpreh se edhe nëse mbyllet kamera, ankuesi mund të bisedojë me lektorin në seksionin “chat” dhe ta njoftonte atë.

Ankuesi nuk bie dakord dhe sqaron se pas thirrjes së dytë ai e ka njoftuar lektorin duke i thënë se kamera e tij është e ngrirë. Por, pavarësisht kësaj, lektori e ka penalizuar duke e përjashtuar nga provimi. Ndërhyrja e lektorit nuk është proporcionale, pasi z. M.S. theksoi faktin se ai është student ekselence, që po kryente provimin për të përmirësuar notën e marrë më parë. Pas përjashtimit, ankuesi ka sqaruar se i ka shkruajtur lektorit për arsyen e përjashtimit, por ai i ka kthyer përgjigje duke i cituar shkeljen e neneve të Rregullores. Ankuesi sqaroi se përveç sa më sipër, ai jeton në zonën e Freskut, ku lidhja me internetin ndërpritet shpesh.

Në vijim, KMD e pyeti z. E.M. dhe zv/Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, nëse regjistrimi i provimit të datës 08.09.2021 ruhet dhe administrohet nga fakulteti, në mënyrë që KMD të sqarojë detaje, që lidhen me këtë provim, mbi çështje teknike të përmendura në këtë kontekst. Z. E.M. sqaroi se në Platformën Microsoft Teams nuk regjistrohen filmimet e bëra nga kamera, por regjistrohet çdo gjë e shkruajtur në “chat”, përfshirë këtu përgjigjet e dhëna nga studenti, pikët e marra, përgjigjet e sakta dhe gjithshka që ka të bëjë me vlerësimin e studentit. Provimi ka qenë me shkrim me alternativa. KMD kërkoi të administroheshin chat-et e studentëve dhe z. E.M. sqaroi se një gjë e tillë është e mundur.

Zv/Dekani i Fakultetit të Drejtësisë sqaroi se për sa i përket Platformës Microsoft Teams (audio dhe video) është e pamundur që të ruhet në serverin e fakultetit, pasi serveri kryesor ndodhet në Rektorat, për të gjitha fakultetet. Pas përfundimit të provimeve materialet fshihen automatikisht, për shkak të ngarkesës së tij, të madhe. Kjo pasi, Fakulteti Juridik përmban disa programe studimi bachelor dhe master. Kapaciteti i serverit nuk mjafton për të ruajtur të gjitha këto regjistrime. Ai kërkoi që duhet të administrohej shkresa e KMD-së për të kërkuar informacionin përkatës lidhur me kohën përgjatë së cilës ruhen regjistrimet, duke theksuar faktin se regjistrimet e mëparshme zëvendësohen me regjistrimet e provimeve më të fundit. Ndër të tjera, Zv./Dekani theksoi faktin në kushtet e pandemisë Covid-19, si studentët ashtu edhe lektorët mund ta zhvillojnë provimin, jo vetëm në ambientet e fakultetit, por në çdo ambient tjetër ku kanë siguruar logjistikën e nevojshme për të kryer provimin.

I pyetur nga KMD, nëse ka patur raste të tjera analoge me z. M.S., pra studentë të përjashtuar nga provimi, si pasojë e shkëputjes së lidhjes me kamera në provimin e zhvilluar *on line*, Zv/Dekani i Fakultetit të Drejtësisë u shpreh se do ta mbante shënim një kërkesë të tillë, por me aq sa kishte

dijeni në provime të tjera të zhvilluara personalisht *on line*, problematika e kamerave është adresuar dhe kamerat kanë qenë të detyrueshme për t'u mbajtur hapur. Për analogji, ai e krahasoi momentin objekt ankese me rastin, kur zhvillohet një provim në klasë dhe studenti shkon në klasën tjetër, pra nuk është vizualisht përballë lektorit.

Z. M.S. sqaron se referuar Rregullores së UT, provimi i regjistruar ruhet në serverin qendror brenda 21 ditëve nga dita e zhvillimit të provimit *on line* dhe në kushtet kur ai e ka ankimuar vlerësimin e bërë në këtë provim brenda 48 orëve nga zhvillimi i provimit ka qenë detyrim nga institucionet përgjegjëse, ruajtja e regjistrimit të këtij provimi.

Në këtë kontekst, Komisioneri vuri në dukje faktin se ankesa e z. M.S. është depozituar pranë KMD-së tej afatit 21 ditor, brenda së cilit duhet të ruhet regjistrimi i provimit të datës 08.09.2021, si dhe theksoi faktin se atij i është dhënë mundësia për të shprehur objeksionet e tij, pasi ndërmjet tij dhe lektorëve është zhvilluar një takim mbi ankesën e tij të depozituar në fakultet. Këtë seancë KMD e ka dëgjuar, pasi është depozituar në cilësi prove nga Rektorati.

KMD e pyeti ankuesin nëse ka depozituar ankesë me objekt diskriminimi pranë Fakultetit të Drejtësisë ose në Rektorat. Ankuesi u përgjigj se ka depozituar një ankesë të tillë në Rektorat, ku është shprehur se po trajtohet ndryshe dhe po diskriminohet, si dhe ka patur edhe takim me Rektorin. KMD e pyeti ankuesin nëse ankesa e tij e depozituar pranë Komisionerit, adresohet ndaj lektorit apo edhe kundër institucioneve të tjera, të cilat nuk kanë vepruar në vijim. Ankuesi u shpreh se ankesa e tij drejtohet kundër lektorit E.M., sikurse edhe ndaj të gjithë subjekteve të tjera që nuk i kanë dhënë zgjidhje çështjes së tij, përfshirë këtu Përgjegjësen e Departamentit të së Drejtës Publike, Dekanin dhe Rektorin.

Ankuesi sqaron se motivacioni i përjashtimit të znj. H.K. është i njëjtë me atë të ankuesit dhe se znj. H. K. e mohon një gjë të tillë. Ai shprehet se mbështetur në mesazhet e saj, ajo e ka mohuar një gjë të tillë. Ajo është përjashtuar pasi nuk i ka bërë dot “*submit*” përgjigjeve të provimit. Mesazhet e znj. H.K. janë dërguar në cilësi prove pranë KMD-së.

Në përfundim të seancës dëgjimore, KMD e pyeti ankuesin se cila është kërkesa e tij ndaj KMD-së. Ankuesi shprehet se kërkon konstatimin e diskriminimit të tij, për shkak të gjinisë nga ana e pedagogëve të lëndës e drejta ndërkombëtare publike.

Z. E.M. vijoi me kundërshtimet e tij, duke theksuar faktin se studenti M.S. ka pretenduar se është student i shkëlqyer, ndërkohë që sipas nenit 66/3 të Rregullores së UT, përcaktohet se të tillë janë të gjithë ata studentë të cilët në 80% të lëndëve kanë marrë nota 10 dhe në pjesën tjetër të tyre, notën 9. Studentëve të tillë u akordohet edhe certifikata e studentit të shkëlqyer. Në këtë kontekst, z. E.M. i është drejtuar ankuesit duke e pyetur nëse ai është vërtet student i shkëlqyer. Ankuesi sqaron se ai nuk i ka të gjitha notat të tilla, kjo për shkak të lektorit E.M. dhe për shkak të një lektori tjetër (e drejtat administrative 2) që e ka penalizuar në këtë drejtim. Por, fakti që mesatarja e tij është mbi 9 dhe në bazë të VKM nr. 40, përcaktohet që studentët që e kanë mesataren 9-10 përfitojnë bursë, në bazë të këtij interpretimi rezulton se ai është student i shkëlqyer. I pyetur sërish nga lektori E.M.,

nëse pjesën tjetër të notave i ka 10 (dhjeta), ankuesi përgjigjet se në lëndën e ekonomisë është vlerësuar me notën 9 (nëntë) dhe në lëndën e histori e shtetit dhe e së drejtës ku është vlerësuar me notën 8 (tetë). Por, ai theksoi faktin se do të merrte pjesë në provimet përkatëse për të përmirësuar notat në këto lëndë. I pyetur sërish nga z. E.M., nëse me këto nota ai sërish e konsideronte veten student të shkëlqyer, ankuesi u përgjigj se në bazë të interpretimit të VKM-së së sipërcituar ishte i tillë, pasi VKM qëndron më lartë në hierarkinë e akteve, se sa Rregullorja e UT-së.

Z. E.M. sqaroi se ankuesi nuk është student ekselence, pasi sipas listës së notave rezultoi se ai është vlerësuar në disa lëndë me notat 5 (pesë) në lëndën “E Drejtë Administrative 2”, 8 (tetë) në lëndën “Historia e Shtetit dhe të së Drejtës” dhe notën 9 në lëndën e “Hyrje në Ekonomi”, duke e përjashtuar automatikisht mundësinë e të konsideruarit si student ekselence.

Z. E.M. thekson se faktet e parashtruara nga ankuesi, duke e konsideruar veten si student ekselence nuk janë të vërteta. Përveç kësaj ai theksoi faktin se sikurse rezultoi nga kjo seancë dëgjimore, ai i ka shkruar në e-mail, për një raport të KMD-së, i cili nuk ekziston dhe një fakt i tillë është pohuar edhe në seancë dëgjimore nga vetë Komisioneri. Z. E.M. theksoi faktin se këto fakte vënë në pah raportin jo të shëndetshëm që ankuesi ka me të vërtetën.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se ai ka ndërhyrë pranë Avokatit të Popullit, në lidhje me ankesën e tij, z. E.M. sqaron se ky institucion i ka dërguar e-mail, në muajin janar 2022, ku në mënyrë të shprehur ka theksuar faktin se distancohet nga pretendime të tilla të pabaza dhe spekulative të ankuesit. Me shkresën përgjigje të këtij institucioni ka rezultuar se të gjitha veprimet e ndërmarra nga institucionet përkatëse janë të drejta.

Z. E.M. vë në dukje gjithashtu faktin se ankuesi ka problematika edhe lidhur me mirënjohjen. Në lidhje me provimin e lëndës e drejta ndërkombëtare publike të zhvilluar në muajin qershor 2021, z. E.M. e pyet ankuesin lidhur me pikët e marra në këtë provim. Ankuesi përgjigjet se ka marrë mbi 50 pikë. Lektor i përgjigjet se z. M.S. ka marrë 50 pikë në provimin e kësaj lënde. I pyetur sërish nga z. E.M., se si do të vlerësonte vetën ai në bazë të tabelës së vlerësimit dhe angazhimit të tij gjatë vitit akademik, ankuesi u shpreh se nota 8 (tetë) është e drejtë dhe e përshtatshme në rastin e tij. Z. E.M. përdori për analogji e-mailin që i ka drejtuar një studenteje, në muajin qershor 2021, lidhur me vlerësimin e saj në provim, ku citon se: sistemi i vlerësimit në provim është 0-40 pikë – nota 4 (katër), 41-50 pikë – nota 5 (pesë), 51-60 pikë- nota 6 (gjashtë) e kështu me rradhë 91-100 – pikë - nota 10 (dhjetë). Kjo do të thotë që edhe sikur ankuesi të ketë qenë i shkëlqyer gjatë vitit akademik në këtë lëndë, pikëve të marra nga ana e tij në këtë provim i shtohen 10 pikë të tjera, duke llogaritur totalin e pikëve në 60 të tilla. Në këto kushte, ai duhet të vlerësohej me notën 6. Përkundrazi, ai jo vetëm nuk e ka vlerësuar me këtë notë, por e ka vlerësuar 2 nota më tepër nga sa meritonte, duke u vlerësuar me notën 8 (tetë). Ankuesi e mohon këtë fakt se kjo nuk është meritë e lektorit, por si rrjedhojë e zhvendosjes së kufirit të notës, që lidhet me kushtet, në të cilat nxënësit kanë zhvilluar mësim etj. Por, pavarësisht kësaj, ai nuk ka qenë i kënaqur me këtë notë dhe ka marrë pjesë për ta përmirësuar atë.

Z. E.M. sqaroi se në cilësi prove ka sjellë edhe një procesverbal provimi të kësaj lënde, të zhvilluar në qershor 2021, ku rezulton se nga 181 studentë pjesëmarrës, 91 të tillë janë vlerësuar me notën 4. Nga këta, 70 janë femra dhe pjesa tjetër janë meshkuj, fakt që dëshmon dukshëm që gjinia tjetër nuk ka qenë e favorizuar nga ana e tij në provime.

Lektori sqaron se në raste të tjera analoge të administruara nga Platforma Teams rezulton se studentë të tjerë, gjatë provimit *on line* kanë kopjuar, duke marrë pjesë nga dokumente të ndryshme të publikuara në internet dhe këto raste janë cilësuar kopjimet përkatëse, si dhe masat e marra ndaj tyre. Lektori citon rastin e disa studentëve të gjinisë femërore dhe mashkullore. Në një rast, z. E.M. shprehet se kopjimi është kthyer në një problem shqetësues në fakultet dhe për këtë arsye citon një e-mail të një studenti, i cili e pranon shkeljen e kryer, pra kopjimin, por duke qenë se është duke mbrojtur diplomën, kërkon si favor nga lektori që të vlerësohet për pyetjet e pakopjuara. Z. E.M. prezanton edhe rastin analog të një studenteje femër, e cila i ka dërguar e-mail, pasi është kapur me kopjim sërish në një faqe interneti. Në e-mailin e dërguar nga lektori i citohet shkelja e kryer nga faqja përkatëse e internetit, duke i vënë në dukje edhe masat disiplinore përkatëse. Z. E.M. thekson faktin se ai mban të njëjtin qëndrim me të gjithë studentët që shkelin Rregulloren e UT. Ai depozitoi në cilësi prove edhe një e-mail të vitit 2020, një studenteje, që i shpreh mirënjohjen për tolerancën në vlerësim.

Z. E.M. depozitoi në cilësi prove në seancë, aktet që vërtetojnë qëndrimin e ndryshueshëm të ankuesit lidhur me personin e tij, ku herë e lavdëron dhe herë të tjera e hedh poshtë, si dhe mbi qëndrimin e institucionit të Avokatit të Popullit ndaj kësaj çështjeje. Ai citon e-maile të studentit të dërguara në adresë të lektorit, ku kërkon falje mbi sjelljen e tij dhe pohon shkeljen e rregullave të provimit. Në një tjetër rast, lektori citon para KMD-së e-mailin, sipas së cilit ankuesi kërkon të ndryshohet procesverbali i provimit dhe kërkon që t'i vihet nota e mëparshme. Përgjigja e pedagogut ka qenë e qartë duke mohuar kërkesën e studentit, duke e konsideruar si fallsifikim.

Ndër të tjera, ai citon në seancë dëgjimore shprehje të z. M.S., në e-maile të ndryshme drejtuar atij, si dhe vë në dukje para KMD-së një foto të montuar dhe të publikuar në rrjetet sociale, ku vihet në lojë lektori E.M..

Ankuesi sqaron se një pjesë e dëshmisë së lektorit është e vërtetë dhe pjesa tjetër nuk interpretohet siç duhet nga ana e tij. Sjelljet e tij, në disa raste, i atribuohen faktit se ai ka qenë i rënduar emocionalisht për shkak të problemeve ligjore, që ka me babain e tij.

- Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtuar me shkresën nr. 268 prot., datë 07.07.2022, Fakultetit të Drejtësisë, nëpërmjet së cilës kërkon të disponojë informacionin e mëposhtëm:
  - Informacion nëse Fakulteti i Drejtësisë, në kuadër të verifikimeve të kryera mbi ankimin administrativ të studentit M.S., disponon versionin audio ose video të provimit të së drejtës ndërkombëtare publike, të zhvilluar në datën 08.09.2021;

- Informacion nëse ka patur raste analoge, me atë të ankuesit M.S., ku studentët janë përjashtuar nga provime të lëndëve të tjera përgjatë vitit akademik 2021-2022, si pasojë e mbylljes së kamerës gjatë zhvillimit të tyre. Nëse po, lutemi të përcillen raste të tilla, pranë KMD-së;
  - Kopje e bisedave të zhvilluara gjatë provimit të së drejtës ndërkombëtare publike, të datës 08.09.2021, ndërmjet lektorëve dhe studentëve pjesëmarrës në provim, të gjeneruara nga Platforma Microsoft Teams;
  - Informacion mbi faktin nëse nota e marrë në lëndën “E drejtë ndërkombëtare Publike” në provimin e datës 08.09.2021, ka qenë faktor penalizues për studentin për përfitimin e bursës në cilësinë e studentit të ekselencës;
  - Informacion mbi faktin nëse studentja H.K. është përjashtuar me të njëjtin motivacion, sikurse ankuesi, nga provimi i së drejtës ndërkombëtare publike, zhvilluar në datën 08.09.2021. Nëse po, të depozitohet në cilësi prove, çdo akt administrativ/e-mail zyrtar i dërguar nga Fakulteti i Drejtësisë, nëpërmjet së cilit znj. H.K. njoftohet mbi një fakt të tillë.
- Fakulteti i Drejtësisë dërgoi pranë KMD-së shkresën nr. 268/1, datë 18.02.2022, bashkëlidhur së cilës ndodhen akte, të cilat i japin përgjigje, çështjeve respektive, për të cilat kërkon informacion KMD.
  - Shkresa e sipërcituar e Fakultetit të Drejtësisë iu dërgua për dijëni elektronikisht ankuesit M.S..
  - Në vijim, të marrjes dijëni mbi shkresën nr. 268/1, datë 18.02.2022, të Fakultetit të Drejtësisë, ankuesi e kundërshtoi me e-mail, informacionin e dërguar nga ky subjekt.
  - Në e-mailët vijuese të ankuesit, ky i fundit ka dërguar në adresë të KMD-së, Vendimin nr. 2611 prot., datë 04.10.2021, e Rektorit të UT-së “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Posaçme të UT-së “Mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve on line të sezonit të dimrit të vitit akademik 2020-2021”. Këtë ndryshim në vendimin e Rektorit, vetëm 26 ditë pas përjashtimit të tij nga provimi i së drejtës ndërkombëtare publike, ankuesi e lidh indirekt me çështjen e tij.
  - Ankuesi ka dërguar në adresë të KMD-së, sikurse edhe në adresë të Rektorit të UT-së, Dekanin të Fakultetit të Drejtësisë, Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Publike pranë këtij fakulteti, lektorit E.M. etj., me dhjetra e-maile, në të cilat lektori E.M. akuzohet për padrejtësi dhe shkelje të kryera në adresë të tij. Disa prej tyre citohen si më poshtë:

Në e-mailin e datës 03.03.2022, ankuesi shprehet: *“E.M. ndihet i tmerruar nga vendimi që pritet të marrë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Sot, teksa po hyja në zyrën e dekanit të ri të Fakultetit të Drejtësisë, ai ulëriste dhe bërtiste pa etikë duke thënë me zë të lartë: "Dil përjashta". Pa asnjë hezitim dola jashtë, pa i kthyer fjalën, si ai fëmija që i bindet prindit. Por*



ai nuk e meriton. Ndaj tij duhet rebelim dhe revoltë. Ai mendon se zyra e dekanit është private si zyra e tij dhe Znj. F.Sh.. Këta pedagogë e kanë kthyer fakultetin në pronë private me destinacion kënaqjen e qejfeve të tyre personale! Studenti hidhet në rrugë! Studenti i pashpresë! Studenti i lodhur nga kjo metodë dhe filozofi që ata kanë instaluar. Sot, E.M. nuk është më në krye të piramidës gjyqësore. Koincidoi mbarimi i mandatit të tij me vulosjen e paligjshmërisë së veprimeve të tij! Unë do fitoj dhe do qëndroj i fortë dhe stoik deri në fund.”

- Në e-mailin e datës 13.03.2022, ankuesi bën një shtesë në objektin e ankesës së tij, sikurse citohet: *“Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës sime drejtuar "Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi", bëhet një shtesë në objektin e padisë, si më poshtë: Detyrimi i personit juridik "Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë" të dëmshpërblejë palën paditëse në shumën 1.000.000 lekë (të vjetra ) si rrjedhojë e veprimeve/mosveprimeve të paligjshme nga pedagogët e departamentit publik. - Detyrimi të mbetet në fuqi nota e parë 8 (tetë); - Detyrimi të akodohet bursa financiare e mohuar, e studenteve ekselente.”*
- Në e-mailin tjetër të datës 13.03.2022, të dërguar në adresën e KMD-së, sikurse edhe në adresat e personave të sipërpërmendur citohet: *“Veprimet e Z. E.M. dhe pedagogëve të departamentit publik janë haptazi të paligjshme dhe diskriminuese. Këto fakte provohen me një seri provash të faktuara në KMD, në kushtet kur u asgjësua meeting i datës 08.09.2021, ora 14:00, në provimin e lëndës e drejtë ndërkombëtare publike. Cënimi i së drejtës për arsim dhe diskriminimi duke më vendosur në një situatë disfavorizuese në raport me të tjerët për të njëjtin fakt dhe mosngritja e komisionit ad hoc në përputhje me nenin 51 të Rregullores së Universitetit të Tiranës, heshitja administrative e Rektoratit përballë një mosveprimi të tillë; mohimi i bursës nga bordi i administrimit; emërimi i Z.E.M. si Zv Dekan pikërisht në këto momente kritike, ku ndaj tij dhe Fakultetit të Drejtësisë është nisur një procedim administrativ është tendencë e pastër për të ushtruar një lloj forme presioni në vendimmarrjen e Komisionerit. E.M. duhet të mbetet pedagog i thjeshtë derisa të ezaurohet rruga gjyqësore e ankimit administrativ të nisur ndaj tij. Shtesa në objektin e padisë në shumën 10 milion lekë të vjetra vjen si pasojë e prishjes së cilësisë së jetesës, luhatjeve të thella morale dhe shpirtërore që më kanë sjellë aktet e paligjshme të këtij departamenti në një kohë më të gjatë se 5 muaj me rradhë. Gjithashtu djegia e pritshmërive që kisha për të ardhmen, duke më minuar aktivitetin jetësor normal në kushtet e faktit sikur të mos ishin kryer këto veprime, përlligjin sanksionin për dëm ekzistencial. Diskriminimi është vërtetuar “prima facia” sipas direktivës së BE. Është në barrën e të paditurit të provojë të kundërtën. Këtë nuk munda dot t'a bëjë.”*
- Në e-mailin e datës 15.03.2022, ankuesi dërgon falenderim për Rektorin e UT-së ku citohet: *“Në vijim të ankesës administrative drejtuar komisionerit duhet të qartësoj qëndrimin se rektori i ri i Universitetit të Tiranës ka mbajtur qëndrim tolerant, bashkëpunues dhe solidarizues me studentët duke përcjellë frymën e nevojës që pedagogu duhet të jetë afër studentit. Megjithëse në rrugë zyrtare asnjëherë nuk kam marrë përgjigje për ankesën*

ndaj Z. E.M. kjo nuk e zhbën kontributin e Z. Hoxha për të më pritur në zyrë sa herë kam patur shqetësime. Në këtë kuadër analize dua të specifikoj se Universiteti i Tiranës sot ka në krye një jurist me përvojë i cili duhet të përpiqet të prishë imazhin e keq që kanë lënë paraardhësit e tij (dukshëm në vendimet e KMD, disa vendime janë konstatuar diskriminim - njëherësh shkelje të dinjitetit njerëzor)”.

- Në një tjetër e-mail të dërguar sërish në datën 15.03.2022, me titull “Vendimi nr. 145, datë 02.07.2018”, ankuesi shpreh: “Rektorati i Universitetit të Tiranës vazhdimisht ka qënë subjekt i shkeljes së dinjitetit njerëzor, fakt që provohet edhe nga vendimi më lart i KMD (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi) ku provohet pa asnjë ekuivok diskriminimi për shkak të gjinisë. Ankuesja është hequr nga puna pa një procedurë paraprake. Rektorati pretendonte se më përpara i kishte dhënë ankueses "vërejtje me shkrim". Mjafton fakti që KMD nuk ju vendos asnjë provë në dispozicion për të konkluduar që provat në thelb, nuk ekzistojnë. Mbi bazën e kësaj komisioneri konstatoi diskriminim. Thënë më qartë ku dua të dal, dështimi i autoriteteve universitare për të provuar të kundërtën sjell ipso - facto diskriminim të prezumuar”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>6</sup>, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata

<sup>6</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

*ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, neni 17, pika 1, gërma ç), të LMD, të ndryshuar, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e arsimit. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se: *“Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:.....ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.”*

Gjatë shqyrtimit të ankesës nr. 194, datë 29.10.2021, së z. M.S., Komisioneri është shprehur vetëm për ato çështje që bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni i atribuon LMD, i ndryshuar.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.**

**A/1. Lidhur me pretendimin e ankuesit M.S., se është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, për shkak të përjashtimit dhe vlerësimit të tij me notë jo kaluese në provimin e sezonit të vjeshtës të datës 08.09.2021 në lëndën “E Drejtë Ndërkombëtare Publike”.**

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, në Statutin e Universitetit të Tiranës, Rregulloren e Universitetit të Tiranës, të miratuar me Vendimin nr. 5, datë 12.04.2010, e Senatit Akademik të UT, si edhe në kuadër të marrjes së masave mbrojtëse për shkak të situatës së rënduar nga virusi COVID-19, Rektorati i Universitetit të Tiranës ka miratuar Rregulloren e Posaçme të Universitetit të Tiranës *“Mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online të sezonit të dimrit të vitit akademik 2021-2022”*, e ndryshuar.

Rregullorja e Posaçme ka për qëllim rregullimin e mënyrës së zhvillimit të provimeve dhe riprovimeve *online* gjatë sezonit të dimrit të viteve akademike 2020-2021 dhe 2021-2022.

Në nenin 4, pikat 4-5 të kësaj Rregulloreje përcaktohet shprehimisht se:

*“4. Provimet online kryhen nëpërmjet platformës Microsoft Teams ose nga shtëpia. Për evidentimin e njohurive të përfutuara, gjatë procesit të kontrollit të dijeve, studenti duhet të*

paraqitet me pamje “imazhe-video” (video call). Regjistrimi për efekt të vlerësimit të njohurive si dhe të ndjekjes së procedurave të ankimimeve të mundshme, sipas përcaktimeve në nenet 50 dhe 51 të Rregullores së UT-së, do të ruhet për 21 (njëzetë e një) ditë.

5. Gjatë kryerjes së provimeve online, për aq sa është e mundur dhe lejohet nga platforma Microsoft Teams, nga personeli akademik dhe studentët duhet të zbatohen rregullat e etikës akademike. Konstatimi i shkeljes së këtyre rregullave etike do të ndëshkohet sipas kuadrit ligjor sektorial në fuqi. Lehtësimi i zbatimit të rregullave të etikës akademike nënkupton marrjen, por pa u ndalur në to, të masave të mëposhtme:

- Si rregull provimet online me gojë duhet të kryhen me kamera të hapura dhe në vlerësim të lektorit rast pas rasti;
- Gjatë kohës së provimit që kryhet nga shtëpia, studenti duhet t'i përgjigjet thirrjes së lektorit, nëse ai do të verifikojë;
- Studentët, kur ju kërkohet, të mbajnë kamerën hapur gjatë gjithë kohës që kryejnë provimin;
- Të respektohen rregullat për verifikimin e dosjes me punime sipas rregullave kundër plagjiaturës.”

Neni 6, pikat 4-8, të Rregullores së Posaçme parashikojnë shprehimisht disa detyrime të studentëve që japin provimet *on line*. Kështu sipas dispozitës së sipërcituar përcaktohet se:

4. Studenti merr masa që ditën e provimit të plotësojë kushtet teknike për kryerjen e provimit online dhe në ditën e zhvillimit të provimit bën gati lidhjen me platformën digjitale 30 minuta para fillimit të provimit dhe hyn në platformë 15 minuta para fillimit të provimit.

5. Studenti merr të gjitha masat që të ketë kompjuterin dhe celularin në dispozicion dhe në gjendje pune gjatë kohës së provimit.

6. Studenti merr masa që të krijojë kushtet e nevojshme në shtëpi për të kryer provimin; duke qëndruar vetëm në dhomë gjatë kohës së kryerjes së provimit si edhe duke mbajtur kamerën hapur gjatë provimit nëse i kërkohet nga lektori sipas formës së provimit.

7. Pas përfundimit të provimit me shkrim ose të provimit të kryer nga shtëpia, studenti i ruan të gjitha përgjigjet dhe punimin dhe më pas i paraqet menjëherë online, i dërgon në platformë ose me e-mail në adresën e pedagogut, por brenda orarit të parashikuar.

8. Nëse studentit gjatë zhvillimit të provimit i ndërpritet lidhja me internetin, duhet të njoftojë menjëherë pedagogun me një mjet të përshtatshëm komunikimi. Gjithsesi, nëse ndërprerja ndodh gjatë përgjigjeve të provimit me shkrim online dhe nuk krijohet mundësia e rivazhimit të tij gjatë kohëzgjatjes së parashikuar, përgjigjet e dhëna ruhen automatikisht. Nëse ai nuk e ka mbaruar provimin, këtij studenti i jepet e drejta të ribëj provimin në një sezon tjetër duke mos u konsideruar përsëritës.”

Ankuesi M.S. ndjek studimet në Programin e Integruar të Ciklit të Dytë, të Fakultetit të Drejtësisë. Pas përfundimit të vitit të II-të, në kushtet kur, z. M.S. është vlerësuar me notën 8 (tetë)<sup>7</sup> në lëndën “E Drejtë Ndërkombëtare Publike”, ai është paraqitur në provimin e sezonit të vjeshtës, për të përmirësuar notën e marrë në këtë lëndë. Provimi u zhvillua *on line*, nëpërmjet Platformës Teams, mbështetur në rregullat e përcaktuara nga Rregullorja e Posaçme e Universitetit të Tiranës “Mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online të sezonit të dimrit të vitit akademik 2021-2022”, e ndryshuar, në datën 08.09.2021, ora 14:00. Provimi drejtohej dhe mbikqyrej nga lektorja F.Sh., titullare e lëndës dhe lektorët E.M. dhe E. Sh.

Sikurse rezulton nga printimet e Platformës Teams, në datën 07.09.2021, ora 15:47, z. E.M. i ka njoftuar studentët që do të merrnin pjesë në provimin e lëndës “E Drejtë Ndërkombëtare Publike”, në këtë platformë, si citohet: *“Përshendetje, Nesër në orën 13:00 fillon apeli. Të gjithë duhet të tregojnë letërnjoftimin kur të dëgjojnë emrin. Provimi fillon në orën 14:00. Do të jetë me alternativë, si në sezonin e verës. Ju urojmë suksese!”*

Pas mesazhit të sipërcituar të lektorit, z. M.S., në orën 16:11, të datës 07.09.2021, ka shkruajtur në Platformë: *“pse jo me shtjellim siç është vepruar gjithmonë...çfarë ju bëri të ndërroni mendje”*. Z. E.M. i është përgjigjur në datën 08.09.2021, ora 10:45, sërish në Platformën Teams, si vijon: *“Meqënëse mënyra e testimit të studentëve është kompetencë e pedagogëve të lëndës, së bashku me profesoreshë F.Sh.n vendosëm që në respektim të parimit të sigurisë juridike, meqë testimi në sezonin e verës i zhvilluar me alternative, e njëjta mënyrë testimi të përdoret edhe në sezonin e vjeshtës.”* Ankuesi ka vijuar të shkruajë, si vijon: *“I bie që në interpretim a contrario – të gjithë pedagogët që kanë ndjekur standard ndryshe-kanë cënuar parimin e sigurisë juridike-që përmendni.”*

Lektori E.M. nuk ka vijuar të bëjë replikë me ankuesin, i cili para fillimit të provimit në orën 14:00 ka patur një debat *on line* me titullaren e lëndës “E Drejtë Ndërkombëtare Publike”, znj. F.Sh., lidhur me mënyrën se si do të zhvillohej provimi për këtë lëndë në sezonin e vjeshtës. Znj. F.Sh. ka shpjeguar sërish se në përputhje me parashikimin e pikës 2, të nenit 7 të Statutit të UT dhe pikës 4, të nenit 27 të Rregullores së UT është detyrë e ekipit të lëndës të përcaktojë përmbajtjen dhe hartimin e tezës. Njëkohësisht, znj. F.Sh. ka shpjeguar që në kuadër të parimit të lirisë akademike dhe cilësisë, ekipi i lëndës nuk ka detyrimin e llogaridhënies lidhur me mënyrën e përzgjedhjes dhe formulimit të tezës së provimit<sup>8</sup>. Komisioneri nuk disponon printime nga Platforma Teams, ku zhvillohet biseda ndërmjet tyre, por duke u mbështetur në audion e takimit të datës 14.09.2021, të zhvilluar ndërmjet ankuesit dhe lektorëve të lëndës rezulton se ankuesi ka pretenduar se lektorja F.Sh., pasi ka dhënë shpjegimet përkatëse, është shprehur ndaj tij me fjalor denigrues, fyes e poshtërues në sy të publikut të gjerë. Ai pretendon se Kodi i Etikës është shkelur në mënyrë brutale nga ana e saj. Referuar dëshmisë së z. M.S.,

<sup>7</sup> Referuar aktit “Fletë Provimi”, Programi i Integruar i Ciklit të Dytë, i Fakultetit të Drejtësisë, datë 11.06.2021;

<sup>8</sup> Referuar shkresës së datës 12.11.2021, të lektorëve E.M. dhe F.Sh. drejtuar Përgjegjëses së Departamentit znj. K. J.

në këtë takim, rezulton se lektorja ka përdorur shprehjen jo etike “*nuk të jap llogari ty*”, duke e konsideruar këtë shprehje jo korrekte të thënë nga një lektore, pasi i është drejtuar me përemrin vetor “*ty*”, fakt që është konsideruar jo i përshtatshëm për ankuesin. Si kundërpërgjigje, mbështetur në thëniet e z. M.S. në seancë dëgjimore, rezulton se ai i është drejtuar lektores F.Sh. me shprehjet: “*jeni e paedukatë*”, “*keni shpërdoruar detyrën*”, “*nuk është kjo mënyra se si duhet t’i drejtoheni studentit*”, “*nuk është kjo etikë institucionale*”. Referuar thënieve të ankuesit në seancë, lektorja nuk ka vijuar debatin me ankuesin, por ka proceduar me fillimin e provimit.

Z. E.M. është bashkuar në provim në orën 14:00, në momentin e fillimit të tij, për shkak të detyrimeve që ka patur si anëtar i KLGJ-së. Për të shmangur komunikimet dhe kopjimet gjatë provimit, nga lektorët E.M. dhe E. Sh. është kërkuar që studentët të mbajnë kamerat hapur gjatë zhvillimit të provimit.

Në vijim, pas fillimit të provimit në orën 14:13, kamera e ankuesit është shkëputur dhe ka qendruar e tillë për 3 minuta, deri në orën 14:16, moment në të cilin është lidhur sërish. Gjatë periudhës kohore që kamera nuk ka qenë e lidhur, lektori i ka bërë thirrje disa herë ankuesit për t’u rilidhur. Sikurse rezulton nga dëshmitë e tyre në seancë dëgjimore, rezulton se ankuesi i ka dëgjuar thirrjet e lektorit dhe thirrjes së parë të tij, i është përgjigjur duke i shkruajtur në Platformën Teams “*ju lutem më lejoni të bëj provimin*” dhe “*ju po bëni atentat*”. Kjo, pasi ai pretendon se nuk ishte në dijeni të shkëputjes së lidhjes së kamerës. Ankuesi sqaron se vetëm pas thirrjes së dytë ka konstatuar se lidhja me kamera ishte shkëputur nga sistemi dhe i ka shkruajtur lektorit se “*kamera e tij kishte ngrirë*”. Ndërprerjen e lidhjes me kamera, ankuesi e justifikon me faktin se kur provimi realizohet *on line* nëpërmjet celularit, ndërprerje të tilla mund të ndodhin. Një fakt të tillë, ai e mbështet në një mesazh në aplikacionin Whats App të dërguar nga një specialist IT. Shkëputjen e kamerës nga lidhja gjatë provimit, ankuesi e justifikon edhe me faktin se provimin e ka kryer në shtëpinë e tij, tek zona e Freskut, në Dajt, ku interneti ka shkëputje të herëpashërshme.

Për sa më sipër, ankuesi sqaron se e ka njoftuar lektorin që kamera e tij është shkëputur, ndërkohë që z. E.M. sqaron se kamera e tij është rilidhur menjëherë, pasi ai i ka komunikuar përjashtimin nga provimi.

Komisioneri nuk disponon printime të Platformës Microsoft Teams, lidhur me momentin e mësipërm, por pavarësisht kësaj ai është mbështetur në thëniet e lektores E. Sh. në takimin e datës 14.09.2021<sup>9</sup>, ku rezulton se konstatimi i kamerës së mbyllur ka qenë që në orën 14:08 dhe paralajmërimi i z. M.S. nga ana e lektores ka filluar në orën 14:10. Lektorja është shprehur se në kuadër të mos cënimit të së drejtës së ankuesit për arsim, ajo ka kryer rifreskim të kompjuterit dhe celularit, duke menduar se diçka nuk shkonte me to, ndërkohë që kur ka konstatuar se studentët e

---

<sup>9</sup> Referuar regjistrimit audio të takimit të sipërcituar;

tjerë i kanë patur kamerat e hapura dhe z. M.S. e ka patur të pandezur në vijimësi, ka kuptuar se problemi qendronte tek ai. Ajo sqaron se ankuesi nuk i është përgjigjur thirrjeve në mënyrë të përsëritur dhe për këtë arsye ajo ka njoftuar lektorët e tjerë të lëndës. Edhe pas thirrjeve të tyre, ankuesi nuk ka dhënë përgjigje dhe për këtë arsye ai është përjashtuar nga provimi. Në këtë takim, ankuesi shprehet se në kushtet kur paralajmërimi i parë është bërë në orën 14:14, nuk ka rëndësi nëse kamera e tij ka qenë e mbyllur pasi edhe kamerat e disa studentëve të tjerë kanë qenë të mbyllura. Ankuesi thekson faktin se ka patur vetëm 2 (dy) lajmërimet dhe në vijim është skualifikuar nga lektori E.M..

Lidhur me pretendimin e ankuesit se sipas tij edhe studentë të tjerë e kanë mbajtur kamerën mbyllur, por ndaj tyre nuk është marrë një masë e tillë sikundër ndaj tij, z. E.M. dhe znj. F.Sh. kanë sqaruar në shkresën e datës 12.11.2021, drejtuar Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Civile, se i njëjti qëndrim është mbajtur edhe ndaj studentes H.K., e cila nuk e ka mbajtur kamerën hapur dhe është përjashtuar nga provimi dhe është vlerësuar me notë jo kaluese. Znj. H.K. e ka pranuar vendimin e lektorëve dhe nuk e ka ankimuar atë.

Lidhur me situatën e z. M.S., lektorët kanë sqaruar se nga platforma ka rezultuar se ai ka qenë i lidhur me internetin gjatë gjithë kohës, pasi figuronte prezent në takimin *on line* dhe gjithashtu rezultonte të kishte akses në provimin që po zhvillohej. Në këto kushte, lektorët theksojnë faktin se edhe nëse ai ka patur probleme reale me kamerën, ai ka patur mundësi që më shkrim ose me zë t'i njoftonte ata, por realisht nuk e ka bërë një gjë të tillë. Edhe gjatë seancës dëgjimore, ankuesi e ka pranuar se e ka dëgjuar thirrjen e z. E.M., fakt që provon lidhjen e tij me internetin. Lektorët theksojnë faktin se ankuesi ka hapur kamerën, vetëm pasi i është komunikuar vendimi i përjashtimit nga provimi.

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së, ankuesi ka pohuar faktin se nuk ka patur probleme të tilla, në provime të tjera të zhvilluara *on line*, kjo pasi ka përdorur mjete të tjera alternative (kompjuter/lap top). Në këtë kontekst, KMD gjykon se ankuesi ka patur disa detyrime në kuadër të dispozitave të Rregullores së Posaçme të Universitetit të Tiranës “*Mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online të sezonit të dimrit të vitit akademik 2021-2022*”, e ndryshuar, të tilla si: të *merrte masa që ditën e provimit të plotësojë kushtet teknike për kryerjen e provimit online (Neni 6, pika 4), të merrte të gjitha masat që të kishte kompjuterin dhe celularin në dispozicion dhe në gjendje pune gjatë kohës së provimit (Neni 6, pika 5), si dhe të marrë masa që të krijojë kushtet e nevojshme në shtëpi për të kryer provimin; duke qëndruar vetëm në dhomë gjatë kohës së kryerjes së provimit si edhe duke mbajtur kamerën hapur gjatë provimit nëse i kërkohet nga lektori sipas formës së provimit (neni 6, pika 6).* Gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se ankuesi nuk ka marrë masa të tilla, në mënyrë që gjatë provimit të datës 08.09.2021, të mos kishte patur probleme teknike të ndërprerjes së lidhjes me kamera.

Në vijim të përjashtimit të ankuesit, në datën 08.09.2021, ora 14:37, z. E.M. i është drejtuar me e-mail lektoret F.Sh. dhe për dijeni lektoret Enkelana Shala, ku citohet: “*Të nderuara kolege, Në*

*vijim të shkeljeve të përsëritura nga ana e z. M.S., student i vitit të dytë në ciklin e integruar, gjatë zhvillimit të provimit të DNPUs, datë 08.09.2021, u vendos përjashtimi i tij nga provimi, pas thirrjeve të përsëritura që ta ndizte kamerën dhe refuzimit të tij për të respektuar rregulloren e provimit. Bashkëlidhur ju përcjell fotot ku duket qartë që studenti z. M.S. e ka kamerën të fikur, ndërkohë që studentët e tjerë i kanë të ndezuara.” Me e-mailin e së njëjtës datë, ora 14:49, lektori E.M. i është drejtuar sërish dy lektoreve të sipërcituara duke i njoftuar se: “I njëjti qëndrim u mbajt edhe për studenten H.K., për të njëjtën shkelje”.*

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankuesi M.S. ndodhet në shkelje të nenit 4, pika 5.3 dhe nenit 6, pikat 4-6, të Rregullores së Posaçme të Universitetit të Tiranës “Mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online të sezonit të dimrit të vitit akademik 2021-2022”, e ndryshuar, por njëkohësisht KMD çmon se në rregulloren e sipërcituar nuk ekziston asnjë parashikim, sipas së cilit, shkelja e dispozitave të sipërcituara passjell përjashtimin e studentit nga provimi dhe vlerësimin me notën 4.

Referuar nenit 4, pika 5, paragrafi i parë, i Rregullores së sipërcituar parashikohet se: “Gjatë kryerjes së provimeve online, për aq sa është e mundur dhe lejohet nga Platforma Microsoft Teams, nga personeli akademik dhe studentët duhet të zbatohen rregullat e etikës akademike. Konstatimi i shkeljes së këtyre rregullave etike do të ndërshkohen sipas kuadrit ligjor sektorial në fuqi....”. Në rastin konkret, ankuesi ka thyer rregullat etike të përcaktuara në pikën 5, pasi ka mbajtur mbyllur kamerën, për disa minuta, përgjatë kohës së provimit të zhvilluar në datën 08.09.2021.

Referuar akteve të depozituara në cilësi prove pranë Komisionerit, gjatë hetimit administrativ të ankesës nr. 194, datë 29.10.2021, së z. M.S. dhe specifikisht e-mailit të datës 13.09.2021, ora 19:25, të z. E.M. drejtuar ankuesit rezulton se përjashtimi i tij nga provimi i së drejtës ndërkombëtare publike është kryer për shkak të shkeljes disiplinore të parashikuar nga neni 89 i Rregullores së UT. Për këtë arsye, sipas e-mailit në fjalë, ai është vlerësuar me notën 4, njësoj siç veprohet kur studentit e kryen shkeljen gjatë provimit që zhvillohet në auditor, ku i merret fleta e provimit dhe vlerësohet me notën 4 (katër).

Për sa më sipër, në nenin 89, të Rregullores së UT, të miratuar me Vendimin nr. 5/2010 të Senatit Akademik, parashikohet shprehimisht se: “Shkelje e rregullave konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e të tjerëve, rregullat dhe normat etiko-morale të shoqërisë si: kopjimi në provime, fallsifikimi i dokumenteve të ndryshme, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj., kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale.”

Neni 90 i kësaj Rregulloreje parashikon se: “Për veprimet e mësipërme, të kryera gjatë vitit akademik, përfshirë edhe intervalin me vitin e mëparshëm merren këto masa disiplinore:

#### *1. Këshillim me shkrim*



2. Vërejtje me shkrim;
3. Pezullim nga shkolla për atë vit akademik;
4. Ç'rregjistrim nga Universiteti i Tiranës;

*Masa disiplinore “këshillim me shkrim” bëhet nga mbrojtësi i studentëve.*

*Masat disiplinore “vërejtje me shkrim”, “pezullim nga shkolla për vitin akademik” dhe “c'rregjistrim nga UT” bëhet me vendim të dekanit/drejtorit;*

*Kundër vendimit të dekanit/drejtorit për ç'rregjistrim, studenti ka të drejtë të ankohet tek Rektori.*

*Kundër vendimit të Rektorit për ç'rregjistrim, studenti ka të drejtë të ankimohet në gjykatë.*

*Masat disiplinore pasqyrohen në regjistrin e studentëve*

*Studenti konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e një muaji për këshillimin, brenda tre muajve për vërejtjen dhe një viti për pezullimin.”*

Referuar parashikimit të nenit 89, të Rregullores së UT, rezulton se shkelja e kryer nga ankuesi sipas lektorit E.M. ka qenë kopjimi në provim. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se bindja e lektorit se ankuesi ka qenë duke kopjuar, si pasojë e fikjes së kamerës, është e prezumuar, pasi në asnjë rast nuk rezulton që lektori të ketë patur provë konkrete të kopjimit nga ana e z. M.S.. Edhe sikur, studenti të kishte kopjuar gjatë provimit dhe të merret e mirëqenë bindja e lektorit, neni 90 i Rregullores së UT-së, në asnjë rast nuk parashikon përjashtimin nga provimi dhe vlerësimin e studentit me notë pakaluese, por përcakton marrjen e masave disiplinore të sipërcituara.

Përveç sa më sipër, KMD ka konstatuar se shkelja e z. M.S. rezulton e përmendur në e-maile, por jo e materializuar dhe arsyetuar në një Vendim të Dekanit apo Përgjegjësit të Departamentit të së Drejtës Publike, akt, i cili mund të ishte i ankimueshëm pranë organeve kompetente. Në Rregulloren e sipërcituar, në asnjë rast, nuk parashikohet vlerësimi i studentit me notë pakaluese, në rastet e kopjimit të prezumuar nga ana e lektorit.

Referuar aktit Vërtetim-Notash të datës 19.11.2021, rezulton se ankuesi është student me një mesatare të ponderuar 9.083. Mbështetur në aktin Fletë Provimi, të datës 11.06.2021, të programit të Integruar të Ciklit të dytë, të Fakultetit të Drejtësisë për lëndën “E Drejta Ndërkombëtare Publike” rezulton se ai është vlerësuar me notën 8 (tetë) në këtë lëndë. Qëllimi i pjesëmarrjes së tij në provimin e datës 08.09.2021, të lëndës së sipërcituar ka qenë përmirësimi i kësaj note. Vendosja e një note pakaluese në këtë provim e ka penalizuar z. M.S., me mospërfimin e bursës financiare, të cilin e ka përfituar vitin e kaluar akademik<sup>10</sup>.

Neni 91 i Rregullores së UT parashikon gjithashtu se: “*Masa disiplinore merret pasi bëhen verifikimet e nevojshme për shkeljen, dëgjohet vetë studenti dhe merret mendimi i Këshillit të*

---

<sup>10</sup>Referuar shkresës nr. 909/4, datë 15.01.2021, të Administratorit të Fakultetit të Drejtësisë, drejtuar Departamentit të së Drejtës Publike, Prof.Asoc.Dr. K.J.

*Studentëve. Lloji i masës caktohet sipas shkallës së shkeljes, nëse ajo është e përsëritur dhe qëndrimin që mbahet ndaj veprimit të kryer. Si rregull masat disiplinore merren sipas rradhës së mësipërme, përveçse kur çmohet ndryshëm”.*

Gjatë analizës së provave dhe fakteve të administruara rezulton se akti i kopjimit nga ana e ankuesit në provimin e datës 08.09.2021, është i prezumuar dhe i pavërtetuar me prova konkrete nga ana e lektorit E.M.. Shkelja e rregullave të Rregullores së Posaçme pasjell ndërshkimin e ankuesit me masat disiplinore, të parashikuara në nenin 90 të Rregullores së UT-së, po në asnjë rast me përjashtimin nga provimi dhe vlerësimin e tij me notë pakaluese.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se veprimet e ndjekura ndaj ankuesit M.S., duke e përjashtuar nga provimi dhe duke e penalizuar me notë jokaluese, janë bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores së UT, duke e ekspozuar atë ndaj një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues e të padrejtë nga ana e lektorëve të lëndës e drejta ndërkombëtare publike.

## **A/2. Në lidhje me pretendimin e ankuesit për mos ngritjen e komisionit *ad hoc* për verifikimin e pretendimeve të tij.**

Procedura e kryer nga Departamenti i së Drejtës Publike, të Fakultetit të Drejtësisë, për verifikimin e ankesës së depozituar brenda afatit ligjor të përcaktuar nga neni 51 i Rregullores së UT, nga ana e ankuesit M.S. ka konsistuar në përgatitjen e një materiali me shkrim nga ana e lektorëve, që mban datën 12.11.2021, që i është drejtuar Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Publike, si dhe një takimi të mbajtur ndërmjet lektorëve dhe ankuesit në datën 14.09.2021.

Mbështetur në verifikimet e sipërcituara, kjo e fundit i është drejtuar Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë me shkresën nr. 688, datë 15.09.2021, ku titullari informohet mbi ankesën e bërë nga z. M.S., si dhe i bëhet e ditur se ankuesi kërkon ngritjen e një komisioni *ad hoc* për verifikimin e pretendimeve të tij. Ndër të tjera në shkresën e Përgjegjëses së Departamentit citohet: “Pas kontakteve me pedagogët e lëndës dhe verifikimeve nga ana ime, konkludoj se nuk është bërë asnjë shkelje nga pedagogët e lëndës në lidhje me vlerësimin e studentit M.S.. Studenti insiston për ngritjen e një komisioni *ad hoc* me gjithë përgjigjen e marrë nga ana ime. Për këtë arsye, përcjell kërkesën e tij për kompetencë të mëtejshme”.

Për sa më sipër, në nenin 51 të Rregullores së UT parashikohet shprehimisht:

“Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin/drejtorin.

*Dekani/drejtori brenda 48 orësh nga marrja dijani për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad hoc, i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit/drejtorit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.”*

Në vijim, pa kryer asnjë verifikim të mëtijshëm, Dekani i Fakultetit të Drejtësisë i është drejtuar ankuesit nëpërmjet shkresës nr. 688/1, datë 17.09.2021, nëpërmjet së cilës e informon: “Në përgjigje të ankesës tuaj datë 14.09.2021, në lidhje me vlerësimin e provimit në lëndën “E Drejta Ndërkombëtare Publike” rezulton se nga verifikimet e bëra nga përgjegjësjë e Departamentit të së Drejtës Publike nuk është bërë asnjë shkelje nga pedagogët e lëndës në lidhje me vlerësimin tuaj në këtë lëndë”.

Për sa më sipër, KMD gjykon se Dekani i Fakultetit të Drejtësisë, sikurse edhe Përgjegjësjë e Departamentit të së Drejtës Publike duhet të kryenin verifikimet përkatëse, nëse procedurat e ndjekura për studentin M.S. ishin konform dispozitave të Rregullores së UT dhe veprimet e ndërmarra ndaj tij ishin kryer sipas parashikimeve përkatëse të kësaj rregulloreje. Neni 90 i Rregullores së UT-së, në asnjë rast nuk parashikon përjashtimin nga provimi dhe vlerësimin e studentit me notë pakaluese, por në rast konstatimi shkeljeje, përcakton marrjen e masave disiplinore të përcaktuara shprehimisht në të. Një fakt i tillë duhet të ishte konstatuar nga Dekani, i cili duhet të kishte urdhëruar ngritjen e komisionit *ad hoc*, që duhet të kryente verifikimet përkatëse. Masat disiplinore ndaj ankuesit duheshin marrë në përputhje me parashikimin e nenit 90 të Rregullores së sipërcituar. Edhe në rast, se ky Komision do të dilte në përfundim se ankuesi ka kopjuar gjatë provimit të datës 08.09.2021, në referencë të nenit 91 të Rregullores së UT-së, lloji i masës do të duhej të caktohej sipas shkallës së shkeljes, nëse ajo është e përsëritur dhe qëndrimit që mbahet ndaj veprimit të kryer, pasi si rregull masat disiplinore merren sipas rradhës së përcaktuar në nenin 90, përveçse kur çmohet ndryshëm.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se ankuesi M.S. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë dhe Përgjegjësjës së Departamentit të së Drejtës Publike.

**A/3. Lidhur me pretendimin e ankuesit M.S. se është trajtuar në mënyrë të padrejtë, disfavorizuese dhe të pabarabartë, si pasojë e mos kthimit të një përgjigjeje zyrtare nga ana e Rektoratit, mbi çështjen e tij.**

Ankuesi ka drejtuar 2 (dy) ankesa në adresë të Rektoratit të UT, përkatësisht nëpërmjet shkresës nr. 2363 datë 13.09.2021 dhe shkresës 2363/1, datë 20.09.2021, ku kërkon zgjidhje mbi çështjen e përjashtimit dhe vlerësimit të tij si pakalues në provimin e së Drejtës Ndërkombëtare Publike, të zhvilluar në sezonin e vjeshtës, në datën 08.09.2021.

Në ankesën nr. 2363, datë 13.09.2021, ankuesi është ankuar ndaj lektores F.Sh., duke cilësuar faktin se ndaj tij është përdorur një fjalor fyes e denigrues. Në këtë kontekst, ankuesi kërkon nga ana e Rektorit, procedimin disiplinor të lektores, nga Këshilli i Etikës.

Në ankesën nr. 2363/1, datë 20.09.2021, të z. M.S. drejtuar Rektorit të UT-së, ankuesi kërkon shpalljen e pavlefshmërisë së shkresës nr. 688/2021 “*Kthim përgjigje*” të Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë dhe kërkon ndërhyrjen e Rektorit për krijimin e komisionit *ad hoc* për verifikimin e vlerësimit të tij.

Në seancë dëgjimore, ankuesi theksoi faktin se në ankesat e dërguara në adresë të Rektorit, ai është ndalur në diskriminimin e tij nga subjektet respektive dhe se nuk i është kthyer asnjë përgjigje zyrtare nga ana e tij.

Në nenin 19/ç të LMD, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Masat që merren, ndër të tjera, janë: ..... ç) trajtimi efektiv i ankesave për diskriminim në institucion, duke shqyrtuar çdo ankim brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij*”. Nga përmbajtja e shkresave të dërguara nga ankuesi në adresë të Rektorit të UT-së, KMD konstatoi se asnjëra prej tyre nuk ka në objektin e tyre diskriminimin për shkak të gjinisë apo për ndonjë shkak tjetër të përcaktuar në nenin 1 të LMD, të ndryshuar.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se ky institucion nuk i ka kthyer përgjigje shkresave të tij, brenda afatit ligjor. Ai ka sqaruar se është takuar një herë me Rektorin e UT-së, por çështja nuk ka marrë zgjidhje dhe nuk i është dërguar asnjë shkresë zyrtare nga ana e Rektoratit.

Në shkresën nr. 2363/6 prot., datë 22.11.2021, e Rektorit të UT-së drejtuar KMD-së sqarohet se me shkresën nr. 905/7 prot., datë 16.11.2021, Fakulteti i Drejtësisë ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për trajtimin e ankesës së z. M.S.. Njëkohësisht në shkresën e sipërcituar, ky institucion vë në dukje faktin se ankuesi është sqaruar në mënyrë të përsëritur mbi fazat e trajtimit të ankesës së tij, si dhe i janë vënë në dispozicion dokumentet përkatëse.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se çështja e moskthimit të një përgjigjeje zyrtare nga ana e institucionit të Rektoratit të UT-së, në bazë të Ligjit nr. 119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë kontekst, rekomandohet që ankuesi të depozitojë ankesë pranë institucionit të sipërcituar.

## **B. Shkaku i mbrojtur “gjinia”.**

Në ankesën e tij, të depozituar pranë KMD-së, Z. M.S. pretendon diskriminim për shkak të “*gjinisë*”, nga ana e Fakultetit të Drejtësisë dhe nga ana e z. E.M., lektor pranë këtij Fakulteti, si dhe të gjithë subjekteve të tjera të përfshira në këtë proces<sup>11</sup>.

---

<sup>11</sup> Sipas deklaramit të ankuesit në seancë dëgjimore.

“Gjinia” është një prej shkaqeve, për të cilat, ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “gjinisë”, Komisioneri gjykon se “gjinia” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, si dhe ankuesi provohet se i përket gjinisë mashkullore.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – gjinisë.**

Z. M.S. pretendon diskriminim për shkak të “gjinisë”, nga ana e Fakultetit të Drejtësisë dhe nga ana e z. E.M., lektor pranë këtij Fakulteti. Në seancë dëgjimore, ankuesi shtoi listën e subjekteve ndaj së cilëve pretendon diskriminim, duke përfshirë këtu edhe Dekanin, Përgjegjësen e Departamentit të së Drejtës Publike, si dhe titullarë të tjerë që janë përfshirë në procesin e tij ankimes, për përjashtimin nga provimi dhe vlerësimin e tij me notë jo kaluese.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon diskriminim për shkak të gjinisë, shkak ky që gjen mbrojtje nga legjislacioni shqiptar dhe ai ndërkombëtar.

Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht se: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”.

Një ndër parimet themelore të Kartës së Kombeve të Bashkuara (1945) është “Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë”. Parimi i barazisë gjinore u njoh edhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948), e cila afirmoi “të drejtat e barabarta të burrave dhe grave”.

Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB-së (ECOSOC) (1997), është shprehur gjithashtu si vijon: “Integrimi i perspektivës gjinore është procesi i vlerësimit të implikimeve për gratë dhe burrat për çdo veprim të planifikuar, përfshirë legjislacionin, politikat apo programet, në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Integrimi është një strategji për t’i bërë shqetësimet dhe përvojat e grave dhe burrave dimension të pandashëm të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore,

*në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë njësoj dhe pabarazia të mos tolerohet. Qëllimi përfundimtar është arritja e barazisë gjinore.”*

Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore (2004) lidh drejtpërsëdrejti të drejtat e barabarta të grave dhe burrave me *“paqen, demokracinë e qëndrueshme, zhvillimin ekonomik dhe, për rrjedhojë, me sigurinë dhe stabilitetin në rajonin e OSBE-së”*. Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i OSBE-së – i cili përbën kuadrin më të plotë të OSBE-së deri më sot, në udhëzimin e institucioneve të OSBE-së dhe të Shteteve Pjesëmarrëse për barazinë gjinore - thekson nevojën *“për të zhvilluar më tej dhe për të forcuar procesin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të integritit gjinor”*. Plani i Veprimit e detyron OSBE-në që objektivin e integritit të perspektivës gjinore ta përfshijë në të gjitha programet dhe veprimet e veta, si edhe të mbështetë arritjen e këtyre objektivave në asistencën që OSBE-ja jep për Shtetet Pjesëmarrëse.

Në Nenin 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) parashikohet shprehimisht se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”* Nocioni i diskriminimit është interpretuar në mënyrë konsistente nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj ligjore, që ka të bëjë me Nenin 14 të KEDNJ. Në gjykimin e saj në çështjen e Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar GJED (1985) shprehet: *“një ndryshim në trajtim është diskriminues në rast se ‘ai nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm’, që do të thotë, në rast se ai nuk ndjek një “qëllim të ligjshëm” apo kur nuk ka ‘një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet”*.

Nën frymën e akteve ndërkombëtare të mësipërme, ligji nr.9970, datë 24.7.2008 *“Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”* përmban gjithashtu dispozita kundër diskriminimit gjinor. Qëllimi i këtij ligji<sup>12</sup> është: a) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë; b) të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet; c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri. Për sa më sipër, neni 4, i ligjit të mësipërm parashikon shprehimisht: *1. “Barazi gjinore” është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëlloj nga arritjet e zhvillimit të saj.”* Neni

<sup>12</sup> Referuar neni 2, të ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 *“Për barazinë gjinore në shoqëri”*;

6 i këtij ligji përcakton se: *1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t'i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet.*”

Në nenin 2, gërma dh), të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: “Ky ligj ka për qëllim: .....dh) të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë”.

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: ““Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Në Kreun III, neni 17, pika 1, gërma ç), të LMD, të ndryshuar, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e arsimit. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se: “Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:.....ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.”

Kodi i Procedurës Administrative ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Fakultetit të Drejtësisë, Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Publike dhe lektorit E.M., kur Komisioneri gjykon se kemi të bëjmë me prezumim të diskriminimit, për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Edhe neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS<sup>13</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjektet kundër së cilëve drejtohet ankesa nuk janë në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jenë përgjegjës për diskriminimin.<sup>14</sup>

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të depozituara nga ankuesi, Rektorati, Fakulteti i Drejtësisë dhe lektori E.M., si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, rezultoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e lektorit E.M., pasi në bazë të nenit 89, të Rregullores së UT, është akuzuar për kopjim gjatë zhvillimit të provimit në sezonin e vjeshtës për këtë lëndë, shkelje kjo e prezumuar dhe jo e vërtetuar nga ana e lektorit. Në vijim, ndaj ankuesit është marrë masa e përjashtimit nga provimi dhe e vlerësimit me notë jo kaluese. KMD ka konstatuar shkelje të dispozitave të Rregullores së Posaçme nga ana e ankuesit, pasi ai ka patur detyrim për të mbajtur kamerën hapur gjatë provimit, ashtu sikurse është kërkuar nga lektorët, si dhe ka patur detyrim për të siguruar të gjitha kushtet teknike, për të mos patur probleme me karakter teknik të lidhjes me internet gjatë provimit, të cilave duhet t’u kishte kushtuar rëndësi dhe t’i kishte plotësuar, më mënyrë që të shmangej situata e ndodhur, gjatë provimit të datës 08.09.2021. Referuar nenit 4, pika 5, paragrafi i parë, të Rregullores së Posaçme parashikohet se: “Gjatë kryerjes së provimeve online, për aq sa është e mundur dhe

<sup>13</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

<sup>14</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.



lejohet nga Platforma Microsoft Teams, nga personeli akademik dhe studentët duhet të zbatohen rregullat e etikës akademike. Konstatimi i shkeljes së këtyre rregullave etike do të ndërshkohen sipas kuadrit ligjor sektorial në fuqi....”. Në rastin konkret, ankuesi ka thyer rregullat etike të përcaktuara në pikën 5, pasi ka mbajtur mbyllur kamerën, për disa minuta, përgjatë kohës së provimit të zhvilluar në datën 08.09.2021. Në këtë kontekst, ndaj tij do të duhet të ishin zbatuar procedurat për marrje mase disiplinore të parashikuara nga neni 91 i Rregullores së UT. Edhe në rast se lektori E.M. do të kishte prova të mjaftueshme për të vërtetuar që ankuesi kishte kopjuar gjatë provimit, sërisht ndaj tij do të duhet të ishin zbatuar parashikimet e nenit të sipërcituar. Në kundërshtim me sa më sipër rezulton se nuk janë ndjekur procedurat e parashikuara në nenet 90-91 të Rregullores së UT, por ankuesi është përjashtuar nga provimi dhe është vlerësuar me notë jo kaluese.

Njëkohësisht, KMD ka konstatuar se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë dhe disfavorizues edhe nga ana e Dekanit dhe Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Publike, pasi këta të fundit nuk kanë kryer verifikimet e duhura lidhur me zbatimin e Rregullores së UT-së për sa i përket ndjekjes së procedurave përkatëse dhe marrjen e masave të duhura ndaj ankuesit sipas Rregullores së UT, për shkeljet e kryera nga ai. Përgjegjësja e Departamentit ka deklaruar me shkresë zyrtare drejtuar Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë se lektorët nuk kanë kryer shkelje dhe se ka kryer verifikimet e saj lidhur me këtë çështje.

Mbështetur në këtë shkresë, Dekani i Fakultetit Juridik nuk ka ngritur komisionin *ad hoc* për kryerjen e verifikimeve përkatëse për rastin e z. M.S.. Komisioneri gjykoj se Dekani i Fakultetit Juridik duhet të kryente verifikimet e nevojshme, lidhur me zbatimin në mënyrë korrekte të parashikimeve të Rregullores së UT në lidhje me shkeljet e kryera nga studenti dhe të ngrinte Komisionin *ad hoc*, që do të verifikonte mënyrën e vlerësimit të ankuesit.

Fakulteti i Drejtësisë dhe lektori E.M. kanë sqaruar pranë KMD-së se masë e njëjtë me ankuesin është marrë edhe ndaj znj. H.K., studente pranë Fakultetit të Drejtësisë, e cila ka marrë pjesë në provimin e sezonit të vjeshtës për lëndën “E Drejtë Ndërkombëtare Publike”, të datës 08.09.2021. Ankuesja nuk ka paraqitur ankesë lidhur me masën e marrë ndaj saj apo motivacionin mbi të cilin është marrë masa përkatëse dhe nuk e ka kundërshtuar atë zyrtarisht brenda afatit ligjor pranë titullarëve kompetentë pranë Fakultetit të Drejtësisë. Lektori E.M. dhe Fakulteti i Drejtësisë kanë theksuar faktin se motivacioni i përjashtimit nga provimi dhe vlerësimit me notë jo kaluese për znj. H.K. është i njëjtë e atë të ankuesit, fakt që vërtetohet qartësisht nëpërmjet e-maileve të dërguara nga z. E.M. në adresë të znj. F.Sh. dhe Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Publike, menjëherë pas zhvillimit të provimit. Ankuesi nuk e pranon një fakt të tillë dhe ka depozituar pranë KMD-së biseda të zhvilluara me znj. H.K. ku ajo mohon të jetë përjashtuar nga provimi dhe të jetë vlerësuar me notë jokaluase si pasojë e fikjes së kamerës. Në kushtet kur, ankuesja nuk e ka ankimuar vendimmarrjen e lektorëve, KMD çmon se motivi i përjashtimit të saj nga provimi është i njëjtë me atë të ankuesit. Pavarësisht motivacionit, të dy studentët janë vlerësuar me notë jo kaluese, fakt që vërtetohet

qartë në aktin Fletë –Provimi, të datës 09.09.2021, Sezoni i Vjeshtës, për vitin II – E drejta ndërkombëtare publike, për vitin akademik 2020-2021, të nënshkruar nga personat përgjegjës të Fakultetit të Drejtësisë.

Njëkohësisht, në provat e administruara sa më sipër rezulton se edhe dy studente të tjera të gjinisë femërore janë vlerësuar me notë jo kaluese në provimin e sezonit të vjeshtës për lëndën e sipërcituar. Këto studente janë: znj. E.R. dhe znj. B.B. Në këtë kontekst, KMD gjykon se nëse qëllimi i lektorit E.M. do të kishte qenë favorizimi i studenteve të gjinisë së kundërt me atë të ankuesit, në provimin e datës 08.09.2021 nuk do të kishte vlerësuar me notë jo kaluese edhe 3 (tre) studente femra, njëra prej të cilave është përjashtuar nga provimi të njëjtin motivacion me z. M.S. Përveç sa më sipër, z. E.M. ka depozituar në cilësi prove gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së, akte të tjera administrative që vërtetojnë se ai ka vlerësuar studentët në provime, pa asnjë lloj dallimi që mbështetet në gjininë e tyre. Kështu, sipas akteve Fletë Provimi, të datës 28.06.2021, të vitit të parë të Masterit Shkencor/Publik, në lëndën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Politika e Jashtme dhe Diplomacia, janë vlerësuar me notën 4 (katër) rreth 50 studente femra, numër ky i konsiderueshëm në raport me numrin e përgjithshme të studentëve pjesëmarrës në provim.

Referuar standardit të provës të parashikuar nga neni 82/2 i Kodit të Procedurave Administrative dhe neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, si dhe bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pala ankuese nuk arriti të krijojë një prezumim të diskriminimit, pra një diskriminim *prima facie*. Pavarësisht, konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të disfavourshëm ndaj ankuesit nga ana e subjekteve përkatëse dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur të diskriminimit - *gjinia*, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar bindjen dhe për të prezumuar se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesi është si rezultat i gjinisë dhe se në mungesë të saj, ankuesi do të ishte trajtuar ndryshe. Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, subjektet përkatëse nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm, të cilit i është nënshtruar ankuesi nuk përbën diskriminim.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se z. M.S. nuk është diskriminuar për shkak të gjinisë nga ana e Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Publike dhe lektorit E.M..

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 17, pika 1, gërma ç), nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të “*gjinisë*” të z. M.S., nga ana e Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Publike pranë këtij Fakulteti, lektorit E.M., si dhe të gjithë subjekteve të tjera të përfshira në këtë çështje.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha – Arsim  
Shkak – gjinia  
Lloji i vendimit - mosdiskriminim